

KONTRATA SOCIALE TIRANË

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE SHTATOR 2022-SHTATOR 2023

Viti i IV i monitorimit

PËRGATITUR NGA:
QENDRA "ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM"



POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE
Shtator 2022 – Shtator 2023



Rrjeti “**Përballja e Ofertave Politike – POP**”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjimore per Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra "Për Zhvillimin e Shoqërisë Civile", Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë;
- Qendra "Epoka e Re", Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë.

Ky Raport është përgatitur nga Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim” në kuadër të projektit POP 2023 “Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparencë” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.

Tabela Përmbledhëse

TABELA PËRMBLEDHËSE	3
SHKURTIME	4
FALENDERIME	5
HYRJE	6
METODOLOGJIA	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
GJETJE NGA INFORMACIONI I MBLEDHUR NË LIDHJE ME 11 PRIORITETET E KONTRATËS SOCIALE – VITI I KATËRT I MONITORIMIT SHTATOR 2022 – SHTATOR 2023:	8
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE	10
GJETJET NGA MONITORIMI DHE INFORMACIONI I BASHKISË TIRANË	10
PRIORITETI NR. 1:	10
PRIORITETI NR. 2:	10
PRIORITETI NR. 3:	13
PRIORITETI NR. 4:	15
PRIORITETI NR. 5:	16
PRIORITETI NR. 6:	17
PRIORITETI NR. 7:	21
PRIORITETI NR. 8:	22
PRIORITETI NR. 9:	23
PRIORITETI NR. 10:	24
PRIORITETI NR. 11:	26
GJETJET NGA FOKUS-GRUPET ME KOMUNITETIN TIRANË	27
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	33
REFERENCA	35
ANEKSE	37
<i>Aneks 1. Kontrata Sociale e detajuar</i>	<i>37</i>
<i>Aneks 2 – Gjetjet Kryesore të Raportit të Vitit të Parë Monitorues</i>	<i>39</i>
<i>Aneks 3 – Gjetjet Kryesore të Raportit të Vitit të Dytë Monitorues</i>	<i>41</i>
<i>Aneks 4 – Gjetjet Kryesore të Raportit të Vitit të Tretë Monitorues</i>	<i>43</i>
<i>Aneks 5 – Vendimet e Këshillit Bashkiak në lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale</i>	<i>44</i>
<i>Aneks 6 – Peticioni i qytetarëve dorëzuar në bashkinë Tiranë datë 13.10.2022</i>	<i>55</i>
<i>Aneks 7 – Aplikimi i dorëzimit të Peticionit të qytetarëve në bashkinë Tiranë datë 13.10.2022</i>	<i>59</i>

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
GADC	Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
KB	Këshilli Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Kontrata Sociale	11 prioritetet kryesore të identifikuara nga qytetarët gjatë 2019
AZHBR	Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
UKT	Ujësullës Kanalizime Tiranë
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinar
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisciplinar
UMPMM	Urdhri për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme
UMM	Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes
UM	Urdhri i Mbrojtjes

Falenderime

Për të hartuar Raportin e vitit të katërt të monitorimit të Kontratës Sociale, bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Tiranë dhe drejtoritë përkatëse, për vënien në dispozicion të informacioneve të kërkuara; Kryetarin e Bashkisë z. Erion Veliaj, nënkryetarët e kësaj bashkie dhe administratorët e Njësive Administrative për disponibilitetin e tyre në komunikimet e vazhdueshme përgjatë katër viteve të monitorimit të Kontratës Sociale të Tiranës.

Falenderojmë në mënyrë të veçantë qytetarët që pranuan t'i përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) si edhe një falenderim për stafin dhe vullnetarët e Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, të cilët që prej momentit të nënshkrimit të Kontratës Sociale kanë qenë në monitorim të vazhdueshëm të punës së Bashkisë Tiranë dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Gjithashtu, dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP. Gjatë periudhës shtator 2022-2023 për të katërtin vit me radhë, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Ky është viti i katërt i monitorimit të punës së pushtetit vendor për përfshirjen e prioriteteve të qytetarëve dhe përmbushjen e Kontratës Sociale 2019-2023.

Kontrata Sociale në Tiranë¹ përmban 11 prioritete që qytetarët e Tiranës identifikuan në zgjedhjet lokale të 2019. Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (GADC), synoi të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetarë në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, stafin e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të dialogojnë dhe të punojnë për realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale. GADC mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Tiranë, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e bashkisë dhe Këshillin Bashkiak përgjegjës për adresimin e prioriteteve të tyre, por duke përdorur edhe zgjedhjet parlamentare të 2021, advokoi me të gjitha partitë politike dhe kandidatët e tyre për të futur në agjendat politike edhe prioritetet e Kontratës Sociale.

Në vitin e parë të monitorimit të kontratës sociale për bashkinë Tiranë, 70 % e prioriteteve të qytetarëve u adresuan. Gjatë vitit të dytë 75%, gjatë vitit të tretë të monitorimit për përmbushjen e kontratës sociale, bashkia e Tiranës arriti të adresonte 80% dhe në përfundim të vitit të katërt monitorues rreth 85% e prioriteteve të qytetarëve të Tiranës janë adresuar nga bashkia.

Raporti² i vitit të parë monitorues, raporti³ i vitit të dytë dhe raporti⁴ i vitit të tretë monitorues janë ndarë gjerësisht me përfaqësues të bashkisë Tiranë si edhe me qytetarët duke analizuar

¹ Kontrata Sociale me bashkinë Tiranë: <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/07/Tirana-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>

² Raporti i vitit të parë monitorues: https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/11/Raporti_POP_Bashkia_Tirane.pdf

arritjet por edhe punën që duhet bërë për përmbushjen e atyre prioriteteve që janë adresuar më pak dhe kanë nevojë për një vëmendje më të shtuar të pushtetit vendor. Janë dy çështje kryesore që organizata dhe rrjeti po llojnë së bashku me qytetarët: Furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë në të gjithë bashkinë Tiranë si edhe përmirësimi i kushteve në të gjitha linjat e transportit publik. Të dyja këto prioritete janë të një rëndësie të veçantë dhe fokusi kryesor për zbatimin e Kontratës Sociale.

Për të mbërritur në vitin e katërt të monitorimit, gjatë vitit 2023, projekti vazhdoi me **“Forcimi i Angazhimit të Qytetarëve në Qeverisjen Vendore”**, duke vijuar monitorimin dhe bashkëpunimin mes aktorëve kryesorë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve.

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2022 – Shtator 2023.

Gjatë vitit të katërt të monitorimit organizata kishte si qëllim:

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies;
- Të përdorë gjetjet e Raportit studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”⁵ për angazhimin dhe informimin e qytetarëve;
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.
- Të vijojë advokimin për përmirësimin e transportit publik dhe sinjalistikat përkatëse.
- Të organizojë fokus grupe diskutimi me qytetarët për analizimin e adresimit të Kontratës Sociale 2019-2023.

Metodologjia

Për të realizuar raportin, GADC, anëtare e rrjetit POP, u bazua në hapat e mëposhtëm:

- U monitorua puna e Bashkisë Tiranë dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën Shtator 2022 – Shtator 2023;

³ Raporti i vitit të dytë monitorues https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/06/Raporti_POP_Bashkia_Tirane-Viti-i-dyte.pdf

⁴ Raporti I vitit të tretë monitorues: https://popnetwork.al/tirane_raporti-i-trete-monitorues-i-kontrates-sociale-shtator-2021-shtator-2022/

⁵ Raporti Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” Korrik 2022 <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/07/Raport-Bashkia-Tirane-2022.pdf>

- U dërgua një letër-kërkesë me email për informacion, drejtuesve të Drejtorive dhe Departamenteve përkatëse, sipas prioriteteve të Kontratës Sociale;
- U organizuan takime me përfaqësues të bashkisë Tiranë, mbi ecurinë e punës sa i përket përmbushjes së prioriteteve të komunitetit të Tiranës;
- U realizuan fokus-grupe me anëtarë të komunitetit në 10 Njësi Administrative të Tiranës, me pjesëmarrës të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të mëparshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioriteteve të Kontratës Sociale si edhe në monitorimin e saj gjatë viteve⁶;
- U realizuan disa takime me drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale pranë kësaj Bashkie, si edhe me Drejtoreshën znj. Anisa Subashi;
- U monitoruan takimet e ndryshme të përfaqësuesve të Bashkisë përmes TV dhe medias sociale;
- U monitoruan vendimet e Këshillit Bashkiak mbi masat e marra nga vetë Bashkia, në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target-grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Bashkiak;
- U analizua dhe monitorua buxheti i bashkisë për vitet 2022 – 2023 si dhe shpenzimet respektive bazuar në open-data;
- U analizua open-data e bashkisë Tiranë⁷;
- U monitoruan dhe analizuan vendimet e KB⁸ që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale bazuar në punën e rrjetit POP apo edhe nga faktorë të tjerë të jashtëm, të tipit: parashikime të mëhershme në buxhet, plane afatshkurtra apo/dhe afatgjata, puna e organizatave të tjera të cilat mund të kenë ndikuar në përmbushje (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte apo edhe kombëtare).
- Analizimi i monitorimit të mediave audiovizive dhe on line, në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike.

Përmbledhje ekzekutive

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Tiranë, të kryer nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” më poshtë renditen disa nga gjetjet kryesore të dala nga ky monitorim.

Gjetje nga informacioni i mbledhur në lidhje me 11 prioritetet e Kontratës Sociale – Viti i katërt i monitorimit Shtator 2022 – Shtator 2023:

- Veterinerët zyrtarë në Shqipëri janë nën përgjegjësinë e Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar, e cila varet nga Ministria e Bujqësisë. Agjencia ndjek një strukturë organizative dhe është e përfshirë në monitorimin e vazhdueshëm të Njësive Administrative rurale, në përputhje me legjislacionin veterinar aktual.

⁶ Fokus grupe me qytetarët <https://popnetwork.al/category/aktivitete-tirane/>

⁷ Open Data Bashkia Tiranë <https://opendata.tirana.al/>

⁸ Aneksi numër 4

- Bashkia e Tiranës ka shtuar buxhetin për start-ups për të rinjtë, duke e çuar numrin e përfituesve në 42.
- 20 gra janë fituese në projektin “Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes”, përfshirë dy gra kryefamijare, tre nga komuniteti Rom dhe Egjiptian, dhe 3 gra nga zonat rurale.
- Bashkia e Tiranës ka ndërmjetësuar 1629 raste për punësim me institucionet përkatëse.
- Njëpërmjet Skemës Kombëtare për mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural, nga buxheti i qeverisë shqiptare në bashkinë e Tiranës kanë përfituar 299 fermerë.
- Është hapur Tregu Ushqimor Farkë me tarifë minimale për tregtarët e vegjël, nën administrimin e Bashkisë së Tiranës.
- Përfshihen nga taksa mbi ndërtesat ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që përfitojnë pension pleqërie ose pension social në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët.
- Përfshihen nga pagesa e tarifës së pastrimit pensionistët, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbrit, të sëmurët tetraplegjikë dhe paraplegjikë, si dhe persona të tjerë me aftësi të kufizuara.
- Gjatë periudhës Shtator 2022 - Shtator 2023, Bashkia Tiranë ka ndërtuar/hapur shërbime të reja dhe ka përfunduar ndërtimin e 6 kopshteve të reja.
- Bashkia Tiranë ka ofruar asistencë dhe ndihmë në pranimin e të moshuarve në Qendra Rezidenciale.
- Ka ofruar shërbim gjysmë rezidencial në "Streha Tiranë" për 30 persona të pastrehë, prej të cilëve 7 janë të moshuar të braktisur.
- Bashkia Tiranë ka zhvilluar një projekt në të gjitha Njësitë Administrative, në bashkëpunim me shoqatën RYDER Albania, për të ofruar shërbime të kujdesit shoqëror për të moshuarit në banesë.
- Në dhjetor të 2022, është ngritur një Qendër Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK) në Njësinë Administrative Laprakë.
- Bashkia ka përcaktuar një fond shtesë për të mbuluar kostot e paketës higjeno-sanitare për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht ata paraplegjikë dhe tetraplegjikë.
- Nga këto masa kanë përfituar 3,000 individë/familje në nevojë nga ndihma ekonomike dhe 24,800 persona me aftësi të kufizuara.
- Numri total i personave me aftësi të kufizuara, të cilët kanë përfituar shërbime të specializuara në 7 qendrat komunitare për periudhën 2022-2023, rezultojnë të jetë 323.
- Ka përfunduar ndërtimi i 8 shkollave të reja për vitin shkollor 2022-2023.
- Gjatë periudhës shtator 2022-shtator 2023, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) ka arritur suksese të shumta, duke trajtuar 1621 raste të dhunës me bazë gjinore dhe në familje. Sistemi REVALB është përditësuar me 568 raste të dhunës në familje, ndërsa janë organizuar 32 mbledhje të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve.
- Aktualisht në vitin 2023 në territorin e bashkisë Tiranë janë 7 biblioteka të lagjeve të hapura për publikun sipas njësive administrative.
- Në muajin prill 2023, u prezantua Plani Strategjik 5-vjeçar i Ujësjellës-Kanalizime Tiranë, duke parashikuar që për Tiranën me 24 orë ujë në ditë të përdoret edhe projekti i burimit të

Gurit të Bardhë. Sipas informacioneve publike nga bashkia e Tiranës, në vitin 2023 rreth 65% e familjeve të Tiranës furnizohen me ujë të pijshëm.

- Për prioritetin e Transportit Publik (pajisja me orare e vendqëndrimeve të autobuzëve qytetas) për vitin 2024 Bashkia e Tiranës planifikon shumën prej 43,200,000 Lekë për projektin e monitorimit, menaxhimit dhe kontrollit të transportit publik në qytet, përmes sistemeve inteligjente të transportit, në nivel qendror dhe lokal, si dhe sistemeve të informacioneve në kohë reale për pasagjerët, për disa nga stacionet kryesore.

Analiza e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale

Gjetjet nga monitorimi dhe informacioni i Bashkisë Tiranë

Prioriteti nr. 1:

Shërbime veterinare në zonat rurale: Zgjerim i shërbimit veterinar në Njësitë Baldushk, Dajt dhe Farkë.

Sipas Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, veterinerët zyrtarë në Shqipëri janë nën përgjegjësinë e Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar, e cila varet nga Ministria e Bujqësisë. Agjencia ndjek një strukturë organizative dhe është e përfshirë në monitorimin e vazhdueshëm të Njësive Administrative rurale, në përputhje me legjislacionin veterinar aktual.

Bashkia e Tiranës ka adaptuar ndryshimet në Ligjin për shërbimin veterinar në Shqipëri, i cili është ndryshuar më datë 24.1.2020, sipas informacionit të Agjencisë. Përkatësisht, VKM-ja nr. 475, datë 31.07.2021, dhe Urdhri i Ministrit të Bujqësisë, datë 8.09.2021, kanë specifikuar rolin e pushtetit vendor në këtë fushë. Afati për kalimin e funksioneve nga Njësitë e Qeverisjes Vendore tek pushteti qendror ka përfunduar më datë 15.10.2021. Pas këtij afati, Bashkia Tiranë ka marrë përsipër vetëm detyrën e monitorimit të profilaksisë, duke bashkëpunuar me strukturat e Shërbimit Veterinar Rajonal. VKM-ja nr. 475 ka përcaktuar se vetëm kontrolli dhe trajtimi i kafshëve endacake janë funksion ligjor i Njësive të Qeverisjes Vendore.

Ndërkohë, në Njësinë Administrative Baldushk, ka një nevojë për zgjerim të shërbimit veterinar, ndërsa në Njësinë Administrative Farkë, shërbimi është njoftuar nëpërmjet afishimit të të dhënave kontaktuese të veterinerit të zonës. Megjithatë, sipas raportimeve të banorëve, mungon shërbimi veterinar shtetëror në këtë zonë. Shërbimet për bagëtitë vazhdojnë të ofrohen nga veterinerë privatë. Në krahasim me këtë, Njësia Administrative Dajt ka zgjidhur këtë çështje prej dy vitesh dhe ofron shërbim veterinar në nivel shtetëror.

Prioriteti nr. 2:

Nxitja e biznesit të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël: Zgjerimi i programeve ekzistuese me fokus të rinjtë dhe gratë.

Gjatë monitorimit të këtij viti raportues, bashkia Tiranë ka disa arritje sa i përket nxitjes së biznesit për të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël.

- **Informimi i grave dhe të rinjve mbi programet për nxitjen e biznesit dhe procesin e aplikimit për tu përfshirë në këto programe.**

Me anë të Drejtorisë së Nxitjes së Punësimit, për vitin 2022-2023 bashkia Tiranë hapi thirrjen e V-të për projektin: **“Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes”**

Proçesi i aplikimit dhe zbatimit të projektit, ndoqi hapat vijues:

- Fushata informuese;
- Dorëzimi i aplikimeve Ide biznesi;
- Vlerësimi, renditja e Ide Biznesit;
- Trajnimi për përgatitjen e Planeve të Biznesit;
- Dorëzimi i Planeve të Biznesit;
- Vlerësimi dhe renditja e Planeve të bizneseve;
- Kontraktimi dhe përdorimi i fondeve;
- Udhëheqja;
- Monitorimi dhe vlerësimi;

Proçesi i aplikimit për tu përfshirë në këtë projekt fillon me kandidatet e pranueshëm, të cilët aplikojnë me një ide biznesi, për t’u pranuar që të marrin pjesë në projekt. Së dyti, aplikantët e pranuar trajnohen mbi aftësitë e përgjithshme të biznesit dhe zhvillimin e planit të biznesit, dhe vetëm pas kësaj ata mund të paraqesin planet e tyre të biznesit. Planet e biznesit do të jenë një version më i shtjelluar i idesë së biznesit. Së treti, fituesit e shpallur në rastin e bizneseve të reja (*start-up*), regjistrojnë bizneset e tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nënshkruajnë një kontratë 18-mujore për të marrë financime në formë granti dhe mbështetje për udhëheqje.

- **Rritje e buxhetit për start -up për të rinjtë - rritje të numrit të perfituesve.**

Aktualisht, Drejtoria e Nxitjes së Punësimit është duke e ripunuar Udhezuesin Operacional me disa ndryshime të arsyeshme për mirëfunktionimin e projektit duke rritur kështu numrin e perfituesve dhe mënyrë e pagesës. Kjo, duke qenë se projekti “Të rinjt dhe të rejat drejt një Profesionit” synon të krijojë lehtësi për punësimin e të rinjve dhe të rejave të sapodiplomuar për profesionet e studiuara nëpërmjet bashkëpunimit me subjektet private. Shpenzimet e pranueshme që do të mbulohen nga ndihma përfshijnë: Pagën minimale, Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Përfitues do të jenë të rinjt dhe të rejat deri në 29 vjeç, që janë banorë rezident në Bashkinë Tiranë, që kanë më pak se 12 muaj që kanë përfunduar studimet

universitare brenda apo jashtë vendit me rezultate të larta dhe rezultojnë të papunë. Zbatimi i skemës do të mundësojë punësimin me kontratë të 42 përfituesve me afat të caktuar 6-mujorë.

➤ **Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës;**

Drejtoria e Nxitjes së Punësimit nëpërmjet takimeve si me Subjektet private të cilat operojnë në qytetin e Tiranës edhe me punëkërkuar të ndryshëm, zhvillon herë pas here takime për tu njohur me problematikat dhe për ti adresuar drejt rritjes së punësimit. Për vitin 2022-2023 janë zhvilluar aktivitete me fokus punësimin duke përdorur si pika takimi Qendrat që janë nën administrimin e bashkisë Tiranë. Gjithashtu dhe Panairët e Punës kanë gjeneruar si punëkërkuar edhe subjekte të reja si incentivë për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Bashkia Tiranë ka realizuar shtatë panairë për punësim në bashkëpunim me Dhomën e Tregëtisë, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Agjensinë e Formimit Profesional dhe Kualifikimit.

➤ **Identifikimi i personave me aftësi të kufizuar, grave kryefamiljare apo vajzave nëna dhe integrimi përmes këtyre incentivave.**

Nëpërmjet incentivave të sipërpërmenduar, Drejtoria e Nxitjes së Punësimit, u jep prioritet dhe pikëzime më të lartë grave në grupet e mëposhtme:

- gratë – kryefamiljare;
- gratë nga zonat rurale të Bashkisë së Tiranës;
- gratë me aftësi të kufizuara;
- gratë nga komunitetët Rom dhe Egjiptian;
- gratë dhe të reja nga kategori të tjera.

Tabela 1: Indikatorët 2022-2023

Gra aplikuese në total	50
Fituese	20
Biznes Start-UP	7
Biznes ekzistues	13
Gra kryefamiljare	2
Gra – Komuniteti Rom dhe Egjiptian	3
Gra nga zona rurale	3

Burimi: Bashkia Tiranë

Gjithashtu Drejtoria e Nxitjes së Punësimit, u vjen në ndihmë qytetarëve, qoftë të kategorive vunerabël apo jo, të cilët drejtohen pranë zyrave të kësaj drejtorie për punësim, duke i ndërmjetësuar për punësim në subjektet private të cilat operojnë në Qytetin e Tiranës.

Tabela 2: Ndërmjetësimi dhe Punësimi

	Viti 2022	Viti 2023
Subjekte Bashkëpunuese	200	126
Vende të lira pune	1008	490
Punëkërkues në Total	819	337
Të ndërmjetësuar	1007	622
Të punësuar	131	97

Burimi: Bashkia Tiranë

Prioriteti nr. 3:

Mbështetja e fermerëve: Zhvillimi i programeve ekonomike që mbështesin fermerët – Njoftimi i tyre nga drejtoritë përkatëse në Njësitë Administrative dhe asistencë teknike e profesionale.

1. **Skema Kombëtare** (Skema Kombëtare është mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga buxheti i qeverisë shqiptare). Gjatë vitit 2020 ishin 94 përfitues të kësaj skeme në Bashkinë Tiranë, gjatë vitit 2021 numri i përfituesve ra në 54 në total, ndërsa në vitin 2022 kjo shifër pati përsëri një rritje duke shkuar në 217 përfitues⁹ në total dhe në vitin 2023 numri i përfituesve të kësaj skeme shkoi në 299¹⁰.

Bashkia Tiranë, në kuadrin e politikave të zhvillimit të zonave rurale të Tiranës, me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, po ndërmerr trajnime nga Sektori i Shërbimit Këshillimor në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik Rural.

Tregu Ushqimor Farkë. Fermerët e fshatrave të Tiranës mund t'i tregtojnë produktet e tyre së në tregun e madh ushqimor në Farkë. Ky treg është publik, me tarifë minimale për tregtarët e

⁹ Përfituesit nga Skema Kombëtare <http://www.azhbr.gov.al/skema-kombetare-2022/>

¹⁰ Përfitues nga Skema Kombëtare 2023: <https://azhbr.gov.al/skema-kombetare-2023/>

vegjël dhe nën administrimin e Bashkisë së Tiranës. Puna për ndërtimin e tregut ka përfunduar. Veprimtaria e tregut bujqësor fokusohet kryesisht në ndërlidhjen midis fermerëve, prodhuesve dhe blerësve fundorë; grumbullimin e produkteve të fermerëve individualë dhe sigurimin e mjeteve dhe metodave të përshtatshme për promovimin dhe shitjen e produkteve të tyre si një njësi e vetme, duke mundësuar kështu shitjen e produkteve në volume të mëdha; garantimin e çmimeve të drejta dhe të njëtrajtshme për produktet bujqësore të fermerëve; sigurimin e një oferte të qëndrueshme për produkte bujqësore vendase për blerësit e mëdhenj, etj.¹¹

Shërbimi Këshillimor Bujqësor (Ekstensioni Bujqësor) – Bashkia Tiranë¹²

Bashkia Tiranë, në kuadrin e Politikave të zhvillimit të zonave rurale të Tiranës, me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, po ndërmerr një fushatë për këshillimin e fermerëve dhe sensibilizimin e tyre mbi kultivimin e tokave bujqësore, përshtatjes së kulturave me nevojat e tregut dhe përdorimit sa më efikas të aseteve që ata disponojnë. Shërbimi Këshillimor Bujqësor (ekstensioni) është një nga instrumentat e rëndësishëm për realizimin e politikave të zhvillimit rural që ka për detyrë të kontribuojë në rritjen e prodhimit bujqësor dhe të ardhurave të fermerëve, nëpërmjet përzgjedhjes, përgatitjes dhe shpërndarjes së informacionit si dhe menaxhimit më të mirë të fermës, strategjisë së marketingut dhe financave.

Në thelb, ky shërbim ka si qëllim t'u ofrojë fermerëve asistencë teknike dhe ekonomike në teknologjinë e prodhimit bimor, blegtoral, sigurimin e inputeve cilësore, tregjeve, çmimet, legjislacionin, menaxhimin e fermës, mundësitë e kreditimit, përpunimit, etj.

Shërbimi Këshillimor Publik¹³

Shërbimi këshillimor (ekstensioni bujqësor) është një nga instrumentet e rëndësishëm për realizimin e politikave të MBZHRAU. Në vendin tonë, megjithëse mund të flitet për një sistem pluralist ekstensionit, me aktorë të shumtë si (shërbimet publike, OJQ, projekte të financuar nga donatore etj), shërbimi këshillimor publik është aktualisht ofruesi më i madh, më i organizuar dhe i shtrirë në gjithë territorin e vendit. Ai bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë e vet, me ofrues të tjerë shërbimesh, pjesë të sistemit kombëtar të njohurive dhe informacionit bujqësor. Misioni i këtij shërbimi është sigurimi dhe ofrimi i informacionit dhe njohurive teknike dhe ekonomike për rritjen e prodhimit dhe të ardhurave për kategoritë e ndryshme fermerësh. Ky shërbim jepet falas për fermerët dhe financimi bëhet kryesisht nga MBZHRAU.

Shërbimi këshillimor publik, në nivel qendror organizohet nga MBZHRAU (Sektori Këshillimit dhe Kooperimit Bujqësor) Në nivel rajonal përfaqësohet nga Sektorët e Shërbimit Këshillimor në përbërje të Drejtorive të Bujqësisë, ku në përputhje me specifikat e çdo rajoni, janë 3-4 specialistë të profilizuar (Hortikulturë, Mbrojtje bimësh, Zooteknik dhe Ekonomistë).

¹¹ Tregu Farkë: <https://www.agroalbania.al/single-news.php?id=86>

¹² Informacione për fermerët <https://tirana.al/artikull/suport-dhe-keshilla>

¹³ Këshilla për fermerët <https://bujqesia.gov.al/keshilla-per-fermeret/>

Në nivel terreni zhvillojnë veprimtarinë e tyre Qendrat e Informacioni Bujqësor dhe ekstensionistet ku operon një specialist bujqësie/ekstensionist. Këto qendra ofrojnë për fermerët, por edhe për agrobiznesin, informacion mbi: teknikat dhe teknologjitë për prodhimin bimor dhe blegtoral, inpute cilësore, legjislacionin, menaxhimin e fermës, kooperimin e fermerëve, plane biznesi, mundësitë e kreditimit, marketingun e prodhimeve bujqësore, çmimet e tregjet, potencialet prodhuese, mundësitë e përpunimit, prognoze-sinjalizimin i sëmundjeve dhe dëmtuesve, sigurinë ushqimore, etj.

Shërbimi këshillimor është i pranishëm në komunitetin e fermerëve me forma të ndryshme komunikimi dhe me një sërë aktiviteteve të programuara si: demonstrime, ditë e fushe, takime individuale dhe takime në grup, vizita, trajnime, panaire, seminare, ëorkshope, fletëpalosje, botime, aktivitete për zhvillimin e shoqatave të fermerëve, shkrime, emisione dhe kronika televizive, video etj. Çdo vit, nëpërmjet një programi trajnimi, realizohet kualifikimi i ekstensionistëve, fermerëve dhe të interesuarve të tjerë. Shërbimi këshillimor publik bashkëpunon dhe me ofrues të tjerë të shërbimit këshillimor siç janë ofruesit publikë (QTTB, Universiteti Bujqësor), ofruesit privat të shërbimeve, organizatat prodhuese dhe organizatat jo qeveritare. Veprimtari e rëndësishme e shërbimit këshillimor është edhe nxitja e organizimit të fermerëve. Për këtë realizohen aktivitete ndryshme si trajnime dhe aktivitete për promovimin dhe funksionimin e kooperativave bujqësore, regjistruar sipas Ligjit “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”, Nr.38, datë 05.04.2012, dhe forma të tjera të organizimit të fermerëve.

Pjesë e rëndësishme programit të shërbimit këshillimor tashmë është bërë dhe Bujqësia Organike, me qëllim, nxitjen dhe përhapjen e njohurive për bujqësinë organike midis prodhuesve. Roli të rëndësishëm ky shërbim luan në realizimin e skemave mbështetëse. Në skemat mbështetëse kombëtare, ky shërbim informon komunitetin e fermerëve për këto skema, ndihmon në plotësimin e aplikimeve, hartimin e projekteve të zbatimit dhe gjatë procesit asiston në vazhdimësi fermerët që fitojnë grande.

Në skemën grandeve “IPARD-LIKE” për zhvillimin e Sektorit Agro-Ushqimor në Shqipëri, këshilluesit mbështesin aplikuesit dhe përfituesit e mundshëm (fermerët dhe agro-përpunuesit) në procesin promovimit, informimit, aplikimit dhe të implementimit të projekteve investuese. Gjithë aktiviteti vjetor i këtij shërbimi, bazohet në programin vjetorë të këshillimit të hartuar sipas metodologjisë së planifikimit me pjesëmarrjen e vetë fermerëve dhe periodikisht monitorohet realizimi i këtij programi.

Prioriteti nr. 4:

Taksat bashkiake: *Krijimi i lehtësive për tarifat e taksave bashkiake për kategoritë në nevojë si gra kryefamiljare, invalidë të punës, persona me aftësi ndryshe, vajza-nëna.*

Përrjashtohen nga taksa mbi ndërtesat: Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike; Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose

pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët.

Në kategoritë e përjashtuara nga **pagesa e taksës së përkohshme të infrastrukturës arsimore**, përfshihen pensionistët, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbrit, të sëmurët tetraplegjikë dhe paraplegjikë si edhe personat e tjerë me aftësi të kufizuar, sipas përkufizimit të ligjit nr. 93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".

Në kategoritë e përjashtuara nga **pagesa e tarifës së pastrimit**, përfshihen pensionistët, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbrit, të sëmurët tetraplegjikë dhe paraplegjikë, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuar sipas përkufizimit të ligjit nr. 93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".

Prioriteti nr. 5:

Kopshtet dhe çerdhet: Ndërtimi i kopshteve dhe çerdheve të reja në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë, por sidomos në zonat rurale, në veçanti i çerdheve në Farkë dhe Dajt ku mungon plotësisht ky shërbim.

Gjatë periudhës **Shtator 2022 - Shtator 2023** Bashkia Tiranë ka ndërtuar/hapur shërbime të reja si edhe ka përfunduar ndërtimi i 6 kopshteve të reja, për vitin shkollor 2022-2023, të cilat i shtohen numrit të kopshteve publike të qytetit të Tiranës.

Ndër të tjera, edhe në zona të tjera të bashkisë Tiranë, njësi të ndryshme administrative apo lagje, janë bërë disa rikonstruksione apo ndërtime të kopshteve dhe çerdheve:

Tabela 3: Kopshte dhe Çerdhe

Emërtimi	Njësia Administrative	Kapaciteti i fëmijëve
Kopshti nr. 72 "Buzëqeshja e artë"	11	180
Kopshti nr. 44 "Pema e miqësisë"	11	120
Kopshti nr. 71 "Hojëzat"	8	120
Kopshti nr. 68 "Ishulli i Thesarit"	2	120
Kopshti nr. 49 "Zërat magjikë"	9	120
Kopshti dhe Çerdhja nr. 69 "Kei"	7	160
Kopshti dhe Çerdhja "Ylber"	1	120
Kopshti dhe Çerdhja Ndroq	Ndroq	120
Çerdhja nr. 71 "Bota e fëmijëve"	Lagja 14	170
Çerdhja në vendin e punës "Mediterraneo"	4	
Rikonstruktimi i Kopshtit Nr. 41 "Luledielli"	2	200

Burimi: Bashkia Tiranë

Prioriteti nr. 6:

Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë

➤ Ngritje e shërbimit rezidencial për të moshuarit.

Në përputhje me Vendimin Nr. 518, datë 04.09.2018 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Komunitar dhe Rezidencial, Kriteret dhe Procedurat për Përfitimin e Tyre dhe Masën e Shumës për Shpenzime Personale për Përfituesit e Shërbimit të Organizuar," Bashkia Tiranë është duke vepruar në sektorin e shërbimeve rezidenciale për të moshuarit, duke pasuar disa hapa dhe masat në këtë drejtim:

a) Asistencë dhe Ndihmë në Pranim në Qendra Rezidenciale:

Bashkia Tiranë, në mungesë të Institucioneve Rezidenciale për të moshuarit nën juridiksionin e saj, ka ndërmarrë veprime për ofrimin dhe mundësimin e shërbimeve rezidenciale. Për këtë qëllim, ka një bashkëpunim të ngushtë me Njësinë e Vlerësimit të Nevojave të Rastit dhe ka përkrahur plotësimin e dokumentacionit për pranimin në qendra rezidenciale shtetërore për moshën e tretë. Në bashkëpunim me Shoqatën Humanitare KUKA dhe "Komunitetin Papa Giovanni," ka siguruar shërbime rezidenciale në Qendrat Rezidenciale Jopublike të këtyre shoqatave.

b) Shërbimi Gjysmërezidencial te Qendra Sociale "Strehëza Tiranë":

Bashkia ka identifikuar nevojat për rritje kapacitetesh në Qendrën Sociale "Strehëza Tiranë," e cila është miratuar me VKB nr. 112, datë 27.09.2018. Përmes kësaj qendre, vazhdon funksionimi i shërbimit gjysmërezidencial për të moshuar dhe persona që jetojnë në situatë rruge. Ky shërbim ofron kujdes për individin në aspekte të ndryshme si higjiena personale, ushqyerja, mbështetje psikosociale, aftësim për kujdes personal, dhe orientim për përfitim nga programet dhe projektet e shërbimeve sociale. **Në këtë qendër, aktualisht marrin shërbim 30 persona te pastrehë, prej të cilëve 7 janë të moshuar të braktisur.**

c) Ofrimi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Banesë:

Bashkia Tiranë ka angazhuar një projekt të shpërndarë në të gjitha Njësitë Administrative, në bashkëpunim me shoqatën RYDER Albania, për të ofruar shërbime të kujdesit shoqëror për të moshuarit në banesë. Kjo përfshin shërbime të ndryshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së të moshuarve në komunitet, duke përfshirë aspekte të ndryshme të kujdesit shoqëror dhe aktiviteteve përmirësuese.

➤ Ngritja qendrave komunitare për kategoritë në nevojë

Bazuar në informacionin e dhënë, Bashkia Tiranë ka realizuar një projekt shumë të rëndësishëm në Dhjetor 2022, duke ngritur një Qendër Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK)

në Njësinë Administrative Laprakë. Ky hap ka ndihmuar në plotësimin e objektivit të Bashkisë për zgjerimin e gamës së shërbimeve sociale në qytet.

Qendra Komunitare për PAK ka vendndodhjen në Njësinë Administrative Laprakë dhe është projektuar për të ofruar një paketë shërbimesh multidisiplinare për personat me aftësi të kufizuara. Edhe pse është ngritur në Nj.A. Laprakë, qendra është hapur për të mbuluar nevojat dhe përfitimet e banorëve të kësaj njësie dhe gjithë qytetit të Tiranës.

Ky projekt ka një rëndësi të veçantë për të siguruar qasje të lehtë dhe të barabartë në shërbimet sociale për personat me aftësi të kufizuara, duke përmirësuar kualitetin e tyre të jetesës dhe duke i integruar ata më mirë në komunitetin ku jetojnë. Qendra ofron një gamë të gjerë shërbimesh që përfshijnë sfidat dhe nevojat e kësaj kategorie të popullsisë, duke kontribuar në një mjedis më të përkujdesur dhe mbështetës për të gjithë qytetarët e Tiranës.

- **Shmangia e vonesave në shpërndarjen e ndihmës ekonomike, si dhe mbështetja me më shumë shërbime e familjeve në ndihmë ekonomike, në mënyrë të veçantë përmes strehimit social.**

Me qëllim që të shmangen vonesat në shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe për të ofruar mbështetje shtesë për familjet në nevojë, veçanërisht përmes strehimit social, Bashkia Tiranë ka ndërmarrë disa masa të rëndësishme:

a) Shpërndarja Efikase e Ndhmës Ekonomike:

Bashkia ka ndërmarrë hapa për të siguruar shpërndarjen e ndihmës ekonomike në kohë dhe me efikasitet, duke përfshirë procedura dhe mekanizma të përmirësuarë të administratës së shërbimit social.

b) Mbështetje Përforcuar për Familjet në Nevojë:

Në përpjekje për të rritur shërbimet ndaj familjeve në nevojë, Bashkia Tiranë ka identifikuar nevojat specifike të këtyre familjeve dhe ka krijuar mekanizma të rinj për t'u përgjigjur nevojave të tyre, duke përfshirë përmes shërbimeve të strehimit social.

c) Bashkëpunim me Postën Shqiptare për Pagesat e Ndhmës Ekonomike:

Për të lehtësuar përfituesit e ndihmës ekonomike në marrjen e shpërblimeve të tyre, Bashkia Tiranë ka vendosur një kontratë shërbimi me Postën Shqiptare. Ky bashkëpunim siguron pagesat e shpejta dhe efikase për kategori të vecanta të përfituesve të ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuara.

d) Pagesa Shtesë dhe Kujdes për Personat me Aftësi të Kufizuara:

Bashkia ka përcaktuar një fond shtesë për të mbuluar kostot e paketës higjeno-sanitare për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht ata paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Kjo është një masë konkrete për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës dhe për t'u siguruar ata kanë çdo mbështetje të nevojshme.

Në total, nga këto masa kanë përfituar 3,000 individë/familje në nevojë nga ndihma ekonomike dhe 24,800 persona me aftësi të kufizuara.

➤ **Akses i lehtësuar tek shërbimet sociale të ngritura nga Bashkia për banorët e zonave rurale.**

Njësitë e Vlerësimit dhe Referimit të Rastit, pjesë e strukturave vendore të vlerësimit, kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të lehtësuar aksesin tek shërbimet sociale të ofruara nga Bashkia për banorët e zonave rurale. Përmes zgjerimit të veprimtarisë së tyre, këto struktura janë angazhuar në sigurimin e përfitimeve që kuadri ligjor parashikon për kategoritë në nevojë, duke përfshirë dhe menaxhimin e rasteve në mënyrë efikase.

Në këtë drejtim, janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të personelit, me qëllim që të ofrohet një ndihmë më efikase dhe të adresohet në mënyrë adekuate nevoja e banorëve. Për më tepër, është nxitur bashkëpunimi dhe planifikimi i mirë i shërbimeve të nevojës, duke përfshirë dhe organizatat jofitimprurëse.

Bashkia Tiranë, në përpjekje për të garantuar shërbime sociale cilësore, ka intensifikuar bashkëpunimin me organizatat jo fitimprurëse. Një nga shembujt konkretë është marrëveshja e bashkëpunimit me Shoqatën Kombëtare Edukim për Jetën (SHKEJ) në qershor të vitit 2023. Kjo marrëveshje ka synuar ofrimin e shërbimit lëvizës për familjet në zonat rurale të Bashkisë Tiranë, duke përfshirë një numër të caktuar njësisish administrative si Petrela, Krraba, Bërzhitë, Zall-Bastar, Zall-Herr, Baldushk. Ky shërbim është orientuar sidomos për familjet me probleme sociale, duke theksuar forcimin e rolit të Njësitë të Vlerësimit dhe Referimit të Rastit (NJVNR).

Ky bashkëpunim synon identifikimin e rasteve në zonat rurale dhe ngritjen e shërbimeve specifike, përfshirë ndërhyrjen e hershme, mbështetjen për fëmijët dhe familjet në këto zona. Këto veprime do të realizohen përmes projekteve të mëposhtëm:

- Projekti: "Fuqizimi i Strukturave të Mbrojtjes së Fëmijëve në Nivel Lokal në Zonat Rurale të Bashkisë Tiranë" - **77 përfitues.**
- Projekti: "Back to School" - Programi i bursave për fëmijët Romë dhe Egjiptianë në sistemin e arsimit obligativ në Bashkinë e Tiranës" - **120 përfitues.**
- Projekti: "Hapat e Parë" - Mbështetje për zhvillimin e fëmijëve nga shtatzania deri në moshën 3 vjec në zonat rurale dhe periferike të Bashkisë Tiranë" - **121 përfitues.**
- Projekti: "Forcimi i Reagimit të Mbrojtjes Sociale në Zonat Rurale në Bashkinë e Tiranës" - **228 përfitues.**
- Projekti: "Mbështetje në Distance për Fëmijët nga Zonat Vulnerabel" - **50 përfitues.**
- Projekti: "Zhvillim i Qëndrueshëm i Modeleve të Shërbimeve Multifunkionale për Fuqizimin e Komunitetit" - **688 përfitues.**

Ky angazhim përbën një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të kushteve dhe shërbimeve për banorët e zonave rurale në Bashkinë Tiranë dhe kontribuon në garantimin e një qasje më të drejtë dhe të barabartë në shërbimet sociale për të gjithë komunitetin.

➤ **Shërbime për moshën e tretë për zonat rurale**

Në përpjekje për të përmirësuar cilësinë e jetesës dhe kujdesin për të moshuarit në zonat rurale, Bashkia Tiranë ka ndërmarrë një hap konkret duke filluar nga Shkurti i vitit 2023. Kjo ka ndodhur përmes implementimit të Projektit "Ofrimi i kujdesit në shtëpi për të moshuarit në Tiranë", financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Shoqata Ryder Albania. Ky projekt, me një afat kohor prej tre vitesh, synon të ofrojë shërbime të specializuara multidisiplinare të kujdesit në shtëpi për 850 të moshuar në nevojë dhe 2000 anëtarë të familjes dhe/ose kujdestarë në Bashkinë e Tiranës.

Deri më tani, janë referuar dhe identifikuar një total prej 136 personave të moshuar, ndër të cilët 20 janë banorë të zonave rurale. Pas vlerësimeve socio-ekonomike dhe shëndetësore të kryera, ky grup ka përfituar shërbime të ndryshme shëndetësore, përfshirë vizita mjekësore dhe infermierore, furnizim me ushqim, shoqërim në institucione dhe shërbime të tjera të nevojshme. Përveç kësaj, ata kanë marrë shërbime psiko-sociale nga punonjësit socialë dhe janë referuar në organizata të tjera për mbështetje ligjore dhe shërbime shpirtërore. Këto masa synojnë të sigurojnë kujdesin e nevojshëm dhe mbështetjen për të moshuarit në zonat rurale, duke i integruar ata në rrjetin e shërbimeve sociale dhe duke përmirësuar cilësinë e tyre të jetesës.

➤ **Shërbimet dhe Programet për Personat me Aftësi të Kufizuara në Bashkinë Tiranë**

Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor dhe Shërbimeve të Integruara ka detyrën e zbatimit të përgjegjësive të saj, siç parashikon kuadri ligjor dhe korniza rregullative për çështjet e aftësisë së kufizuar. Përveç kësaj, kjo drejtori ka një rol kyç në promovimin dhe zbatimin cilësor të gjithëpërfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara. Kjo realizohet përmes ofrimit të shërbimeve të drejtpërdrejta, pjesëmarrjes aktive në hartimin e politikave lokale dhe qendrore, si dhe monitorimit të zbatueshmërisë së ligjit, duke u bazuar në konventat ndërkombëtare, në të cilat Shqipëria është palë.

Një pjesë e rëndësishme e punës së Drejtorisë është koordinimi i veprimtarive me qendrat komunitare, të cilat shërbejnë si hallka e parë që përballen me çështjet dhe problematikat e personave me aftësi të kufizuara. Bashkia Tiranë ka ngritur 7 qendra komunitare ditore në territorin e saj, prej të cilave 5 ofrojnë shërbime dhe mbështetje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara. Në veçanti, Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuara ka një mision të veçantë për përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve, të rinjve, grave dhe burrave me aftësi të kufizuara, duke ofruar shërbime cilësore drejt një jete të pavarur.

Kjo qendër mundëson shërbime psiko-sociale, fizioterapi, logopedi, terapi zhvillimi, rritje të kapaciteteve individuale për aftësimin profesional të të rinjve, burrave dhe grave me aftësi të kufizuara. Ofrimi i këtyre shërbimeve është i mbështetur në parimin e kontributit drejt ngritjes së një modeli të qëndrueshëm të integrimi dhe zhvillimit, i cili synon të garantojë mundësinë për të gjithë për të përmbushur nevojat bazë. Numri total i personave me aftësi të kufizuara, të

cilët kanë përfitur shërbime të specializuara në qendrat komunitare për periudhën **2022-2023**, rezulton të jetë **323**.

Objektivat afatgjata të Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shërbimeve të Integruara janë si vijon:

a) Përmirësimi i Shërbimeve të Specializuara në Qendrat Komunitare:

Drejtorja synon të shtojë gamën e shërbimeve të specializuara në qendrat komunitare për personat me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin shërbime rehabilituese, shërbime për zhvillimin e aftësive për jetesë të pavarur, si dhe mbështetje për fuqizimin e familjes.

b) Identifikimi i Hershëm dhe Bashkëpunimi për Zhvillim Efikas:

Drejtorja ka objektivin për identifikimin e hershëm të nevojave të fëmijëve në bashkëpunim me Njësitë Administrative, Qendrat Shëndetësore dhe Qendrat Komunitare. Përmes edukimit të stafit profesional, synohet të përmirësojë procesin e identifikimit, orientimit dhe referimit të rasteve, duke theksuar një bashkëpunim të ngushtë me prindërit.

c) Krijimi i Modelit të Qëndrueshëm për Jetesë të Pavarur për Persona mbi 16 Vjeç:

Drejtorja ka për qëllim ngritjen e një modeli të qëndrueshëm për ofrimin e shërbimeve për jetesë të pavarur për persona mbi 16 vjeç. Kjo përfshin përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve që ndihmojnë individët të jetojnë sa më pavarur.

d) Integrim dhe Ndërmjetësim në Tregun e Punës:

Drejtorja synon të kontribuojë në integrimin dhe ndërmjetësimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës. Kjo përfshin zhvillimin e programeve dhe iniciativave që promovojnë punësimin dhe pavarësinë ekonomike të kësaj kategorie.

e) Ngritja e Një Qendre Rezidenciale për Persona me Aftësi të Kufizuara:

Drejtorja ka objektivin për ngritjen e një qendre rezidenciale dedikuar për personat me aftësi të kufizuara. Kjo qendër do të ofrojë mjedisin dhe shërbimet e nevojshme për një jetë të pavarur dhe të kujdesuar për këtë grup të veçantë të popullatës.

Prioriteti nr. 7:

Ngritja e shkollave të reja në Njësitë Administrative të bashkisë Tiranë

Në vitin e parë të monitorimit, Bashkia e Tiranës ka zhvilluar ndërhyrje dhe rikonstruksione në 12 shkolla brenda territorit të saj, duke përfshirë Njësitë Administrative Baldushk, Dajt, 1, 2, 3, 5 dhe 8.

Në periudhën e monitorimit nga Shtator 2020 deri në Shtator 2021, në bazë të monitorimit të GADC-sw dhe informacionit të përfutur nga Bashkia e Tiranës, janë rindërtuar 6 shkolla. Në të njëjtën kohë, janë ndërtuar nga e para dhe janë hapur për nxënësit në Shtator të vitit 2021 edhe 2 shkolla të tjera. Paralelisht, janë bërë ndërhyrje me punime hidraulike, elektrike, etj., në 27 shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në territorin e Bashkisë Tiranë. 6 prej këtyre shkollave kanë përfitur mirëmbajtje të thellë të tualeteve dhe 5 prej tyre mirëmbajtje të thellë të sistemeve të ngrohjes qendrore me kaldajë.

Gjatë periudhës nga Shtatori 2021 deri në Shtator 2022, Bashkia e Tiranës ka përfunduar rindërtimin dhe rikonstruksionin e plotë të 4 shkollave. Gjithashtu, ka përfunduar ndërtimi i 8 shkollave të reja për vitin shkollor 2022-2023, duke shtuar kështu numrin e shkollave publike në qytetin e Tiranës. Listën e shkollave dhe vendndodhjen e tyre mund ta gjeni në vijim:

- Shkolla e teknologjisë “Holberton”, me seli në Silicon Valley, hap kampusin e ri në Tiranë;
- Hapet shkolla 9-vjeçare “Feti Fanaj” në Mangull të Petrelës;
- Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “Murat Toptani” në Selitë;
- Hapet shkolla e mesme “Kristo Frashëri” dhe shkolla 9-vjeçare “Vaçe Zela” në Don Bosko, njësia administrative nr. 9;
- Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “Agron Hysenlliu” në Pezë të Vogël;
- Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “Hasan Vogli”, Nj.A. nr. 9;
- Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “Mervete Peza” në Pezë Helmës;
- Rindërtimi i shkollës “Qazim Turdiu” në NJ.A. nr. 9;
- Rindërtimi i shkollës “16 Shtatori” në Pezë;
- Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “Lasgush Poradeci” në Kombinat, NJ.A. nr. 6;
- Ndërtimi i shkollës së re 9-vjeçare në zonën e Medresesë, që do të shërbejë edhe për ciklin parashkollor; Nj.A. nr. 8;
- Ndërtimi i gjimnazit të ri pranë Qesarakës në lagjen 12;
- Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “17 Shkurti” në Qesarakë;
- Rindërtimi i gjimnazit “Sami Frashëri”;
- Rindërtimi i shkollës në fshatin Dritas;
- Ndërtimi i shkollës së re 9-vjeçare “Andrea Stefani”, e integruar me parashkollor; pranë rrethrotullimit “Shqiponja”, Nj.A. nr.11;
- Shkolla e re 9-vjeçare “Nënë Tereza” dhe gjimnazi “J. F. Kennedy” në Kodër Kamëz;
- Rindërtimi i shkollës 9-vjeçare “Kosova” në rrugën e Elbasanit, Nj.A. nr. 2;
- Shkolla e re 9-vjeçare “Bashkim Fino” në afërsi të Qytetit Studenti, Nj.A. nr. 2;
- Në ndërtim e sipër shkolla “Bedri Llagami” në Vaqarr; do të hapet në semestrin e dytë;
- Shkolla e re “Kiço Blushi” që përfshin të gjithë ciklin e sistemit parauniversitar, nga parashkollori deri në gjimnaz; NJ.A. nr. 8;
- Shkolla e re “Lekë Gjikhuri” në NJ.A. nr. 8;
- Përfundon ndërtimin shkolla e re në Pajan, Pezë, e rindërtuar pas tërmetit, me hapësira edhe për parashkollorin;
- Rindërtimi i shkollës së mesme “Luan Hajdaraga” në Linzë – njësia Dajt.

Prioriteti nr. 8:

Ngritja e bibliotekave të lagjeve

Aktualisht në vitin 2023¹⁴ në territorin e bashkisë Tiranë janë 7 biblioteka të lagjeve të hapura për publikun sipas njësive administrative.

1. Biblioteka nr. 6 në Kombinat
2. Biblioteka nr. 7 në rrugën Lord Bajron në Laprakë
3. Biblioteka “Musine Kokalari” në Bulevardin “Gjergj Fishta”
4. Biblioteka “Petro Zheji” në rrugën “Petro Marko”
5. Biblioteka “Misto Treska” në rrugën “Mine Peza”
6. Biblioteka “Miokom Zeqo” në rrugën “Tefta Tashko Koço”
7. Biblioteka “Hamit Beqja” në rrugën “Thanas Ziko”

Prioriteti nr. 9:

Zgjerim i programeve ndërgjegjësuese në lidhje me dhunën në familje dhe pasojat e saj

Sipas monitorimit të bashkisë Tiranë si edhe drejtorisë përkatëse dhe mekanizmave të përdorur për adresimin e këtij prioriteti, më poshtë analizohet puna dhe arritjet për periudhën shtator 2022-shtator 2023.

Bashkia Tiranë vazhdon të kushtojë një vëmendje të veçantë të drejtave, mbrojtjes dhe përfshirjes së grave dhe vajzave në veprimtarinë e saj, duke e reflektuar nëpërmjet Mekanizmit të Koordinuar të Referimit. Në një partneritet të ngushtë me Organizatat Jofitimprurëse, Bashkia Tiranë ka luajtur një rol themelor në adresimin e rasteve të dhunës në familje dhe me bazë gjinore.

Në këtë drejtim, Bashkia ka fuqizuar strukturat e mbrojtjes së grave dhe vajzave duke ofruar shërbime multidisiplinare të përqendruara te viktima. Këto shërbime përfshijnë ndihmë ekonomike, strehim social, ndërmjetësim për punësim, Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza, këshillim ligjor dhe psikologjik, si dhe aktivitete të shumta ndërgjegjësuese.

Për të garantuar një bazë ligjore të fortë për veprimtarinë e mekanizmit, janë miratuar 3 Protokollat e standardizuara nga MSHMS për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në periudhë normale, në situatë pandemie, si dhe për rastet e dhunës seksuale.

Gjatë periudhës shtator 2022-shtator 2023, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) ka arritur suksese të shumta, duke trajtuar 1621 raste të dhunës me bazë gjinore dhe në familje. Sistemi REVALB është përditësuar me 568 raste të dhunës në familje, ndërsa janë organizuar 32 mbledhje të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve. Në bashkëpunim me Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza, janë zhvilluar 7 mbledhje me aktorë të institucioneve anëtare të MKR në kuadër të projektit “Ndërtimi i reagimit të qëndrueshëm ndaj dhunës me bazë gjinore gjatë COVID-19 në Shqipëri” 2021 – 2024. Gjithashtu, është organizuar një mbledhje e Komitetit Drejtues të MKR në datën 24 nëntor 2022.

¹⁴ <https://tirana.al/pikat-e-interesit/biblioteka>

Sektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore është përmirësuar me shtimin e një Specialist-Koordinator Vendor gjatë vitit 2022, duke rritur kapacitetet dhe aftësitë e drejtorisë për të përmbushur objektivat afatgjata për mbrojtjen dhe përfshirjen e grave dhe vajzave në komunitetin e Tiranës.

Një pjesë e rëndësishme e përpjekjeve të Bashkisë është fokusi në rehabilitimin e dhunuesve. Bashkëpunimi me Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem ka mundur ofrimin e këshillimit dhe ndihmës së specializuar psikologjike për rehabilitimin e dhunuesve burra dhe djem. Shërbimi i këshillimit për burrat e dhunshëm synon reduktimin e aktet e dhunës dhe zëvendësimin e sjelljeve të dhunshme me sjellje të reja, pa dhunë. Në periudhën shtator 2022-shtator 2023, numri i dhunuesve të trajtuar nga LKBD si pjesë e MKR Tiranë është 147.

Gjatë 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, Bashkia Tiranë ka koordinuar dhe realizuar një sërë aktivitete ndërgjegjëse në bashkëpunim me organizata të ndryshme dhe institucione të tjera. Këto aktivitete përfshijnë takime me nxënësit e shkollave, aktivitete për fuqizimin e vetëmbrojtjes, diskutime dhe ekspozita fotografike për sensibilizimin ndaj problematikës së dhunës me bazë gjinore.

Përgjatë periudhës shtator 2022-shtator 2023, qendrat komunitare të Bashkisë Tiranë dhe Njësitë Administrative kanë organizuar 30 aktivitete ndërgjegjëse kundër dhunës me bazë gjinore.

Prioriteti nr.10:

Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet e ujërave të zeza

Në muajin prill 2023 u prezantua Plani Strategjik 5-vjeçar i Ujësjellës-Kanalizime Tiranë, i cili parashikon qw pwr njw Tiranw me 24 orw ujw nw ditw do tw pwr doret edhe projekti i burimit tw Gurit tw Bardhw. Sipas informacioneve zyrtare nga bashkia e Tiranws, nw vitin 2023 rreth 65% e familjeve tw Tiranws furnizohen me Ujw tw pijshwm.

Ndwrkohw, nwse ju referohemi informacioneve zyrtare të përfituara nga “Ujësjellës Kanalizime Tiranë”, viti 2022 ka një rritje me 10% të mbulimit me ujë 24 orë. Në vitin 2020 sipas UKT, Tirana mbulonte 60% të territorit me ujë pa ndërprerje, ndërsa në vitin e fundit monitorues mbulohet 70% e territorit të Tiranës me ujë 24 orë.

Përmes investimeve të fundit që shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” ka kryer, një pjesë e konsiderueshme e kryeqytetit, ka furnizim me ujë 24 orë në ditë. Kjo hartë është dhe vazhdon të mbetet në zgjerim që pas ndërhyrjeve të kryera në Impiantin e Bovillës. Pjesa Veri-Perëndimore dhe Jug-Perëndimore, duke përfshirë dhe një pjesë të qendrës së qytetit, furnizohet nga Impianti i Bovillës. Pjesa më problematike për furnizim të vazhdueshëm është zona rurale dhe me distancë të largët nga qendrat e banuara. Në vitet e ardhshme parashikohet një sërë investimesh strategjike dhe të gjitha këto krijojnë mundësinë e furnizimit në kushte

optimale, në të gjitha njësitë në territorin e Bashkisë Tiranë, me të njëjtën sasi uji, edhe në lagjet më fundore duke e bërë realitet furnizimin 24 orë ujë në ditë për të gjithë Tiranën.¹⁵

Rritja e orëve të furnizimit me ujë ka ardhur si pasojë e disa investimeve të kryera nga UKT në vitet e fundit, të cilat kanë patur si synim modernizimin e rrjetit të shpërndarjes, minimizimin e humbjeve, shtimin e linjave të reja si dhe shtimin e kapaciteteve trajtuese të ujit në Impiantin e Bovillës. Misioni dhe sfida e UKT është të ofrojë furnizim me ujë të qëndrueshëm, të sigurt dhe të pandërprerë, për të gjithë klientët ekzistues dhe të rinj në zonën e re të shërbimit të Bashkisë Tiranë në përputhje me legjislacionin në fuqi.¹⁶

Qëllimi dhe synimi kryesor i Ujësjellës Kanalizime Tiranë është që në të gjithë Tiranën të mundësohet furnizimi me ujë të pijshëm 24/7. Kjo hartë është dhe vazhdon të mbetet në zgjerim që pas inaugurimit të fillimeve të punimeve të fazës së parë të shtesës së Impiantit Bovillë. Zgjerimi i Impiantit të Bovillës me 40% më shumë të kapacitetit të tij trajtues, tashmë përpunon 2500 l/sek ujë të pijshëm nga 1800 l/sek. Ndër sfidat më të mëdha të shoqërisë së Ujësjellës Kanalizime Tiranë për vitet e ardhshme është modernizimi i rrjetit shpërndarës si dhe kryerja e investimeve të reja në zona ku mungon tërësisht rrjeti për t'i dhënë zgjidhje furnizimit me ujë të banorëve. Tirana është një qytet i cili po zgjerohet dita-ditës dhe vlen të përmendim se ndryshimet demografike në kryeqytet kanë qenë të shumta.¹⁷

Sa i përket sigurisë së ujit të pijshëm, shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sh.a. është në monitorim të vazhdueshëm nga institucionet kompetente, për zbatimin rigoroz të plotësimin të kushteve higjieno – sanitare të puseve dhe stacioneve të pompimit, përcaktuar në “Direktivën e Këshillit të Europës 98/83/EC, datë 03.11.1998, mbi cilësinë e ujit për konsum njerëzor” dhe rregulloren “Cilësia e ujit të pijshëm” miratuar me Vendimin nr.379, datë 25.05.2016 të Këshillit të Ministrave. Shoqëria UKT sh.a. garanton se, uji që del nga depot dhe furnizon rrjetin e shpërndarjes është brenda parametrave të kërkuar dhe është totalisht i sigurtë.¹⁸

Ndërkohë sa i përket përmirësimit të rrjetit të kanalizimeve apo rikonstruksioneve të rrjetit të ujit të pijshëm, sipas monitorimit të kryer nga GADC, rezultojnë disa ndërhyrje pozitive të ndërmarra gjatë vitit 2022 dhe që adresojnë kërkesat e qytetarëve sipas Kontratës Sociale:

- Njësia administrative nr. 1 - Investim në rrjetin e kanalizimeve – Rruga “Ali Demi”; Përfundoi zbatimin e projektit KUZ në rrugën “Ali Shefqeti”
- Njësia administrative nr. 2 – Përfundojnë punimet në rrjetin KUZ në rrugën “Arben Broci”; Zbatimin e projektit për rikonstruksionin e rrjetit ujësjellës në rrugën “Budi”; Kanë përfunduar punimet për projektin KUZ në rrugën “Sali Nivica”; Është zëvendësuar dhe

¹⁵ Faqe zyrtare e UKT Tiranë <http://ujesjellesitirane.al/transparenca/>

¹⁶ Po aty

¹⁷ Po aty

¹⁸ Përgjigje zyrtare nga UKT në vitin 2021

është realizuar spostimi i rrjetit të amortizuar duke bërë të mundur disiplinimin e ujërave të ndotura – rruga “Shyqyri Ishmi”

- Njësia administrative nr. 3 – Në proces rikonstruksioni i rrjetit ujësjellës në rrugën “Kongresi i Manastirit”
- Njësia administrative nr. 4 - Përfundoi zbatimi i projektit të ujësjellësit në rrugën “Omer Nishani”; Rikonstruksioni i rrjetit ujësjellës në rrugën “Niko Avrami”; Rikonstruksioni i rrjetit – rruga “Aleksandër Moisiu”
- Njësia administrative nr. 7 – Ka përfunduar zbatimi i projektit ujësjellës te Fusha e Aviacionit
- Njësia administrative nr. 8 - Përfundoi rikonstruksioni i rrjetit ujësjellës në rrugën “Dervish Hekali”;

Prioriteti nr. 11:

Shtimi i autobuzëve në linjat e Njësive Administrative

Një prej prioriteteve të Kontratës Sociale ishte edhe shtimi i numrit të autobusëve sidomos për linjat e Njësive Administrative rurale Dajt, Baldushk dhe Farkë. Ky prioritet vijon me problematika dhe i adresuar nw mwnyrw tw pjeshme.

Sipas informacionit zyrtar nga Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor, Bashkia Tiranë, rishikimi i frekuencave të lëvizjes së linjave të transportit publik rrethqytetëse ka filluar që në vitin 2017 dhe në vijim, kur ky rrjet linjash iu kalua për planifikim dhe menaxhim Bashkisë sipas ndryshimeve të ligjit 8307, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", me ndryshime dhe ligjit për ndarjen territoriale. Në vijim Bashkia Tiranë përcaktoi rrjetin e ri të linjave rrethqytetëse, duke ofruar një shtrirje më të gjerë të ish komunave, sot të quajtura njësi administrative, pjesë përbërëse të Bashkisë Tiranë. Krahas kësaj Bashkia Tiranë ndryshoi kushtet e komoditetit për linjat rrethqytetëse, duke certifikuar mjete të prodhuara në Bashkimin Evropian, mjete më të reja, si dhe u shtua numri i mjeteve në shërbim, me frekuencë më të shpeshtë.

Sa i takon afishimit të orareve në stacionet e linjave, aktualisht ato janë të afishuara në stacionin e nisjes për linjat me nisje tek fusha pranë Fakultetit Ekonomik. Aktualisht po ndiqet projekti për informatizimin e stacioneve të linjave rreth qendrës së qytetit, dhe në vijim do të shikohet mundësia për më gjerë.

Po sipas bashkisë Tiranë, orari i transportit publik është 06:00 - 23:00 çdo ditë (pavarësisht festave ose ditës së javës) dhe ky orar respektohet edhe bazuar në monitorimin e GADC-së. Numri total i stacioneve është 451 dhe pritja mund të variojë nga 3 deri në 13 minuta sipas linjave të autobusëve dhe orarit (orar piku ose orar normal). Sipas monitorimit pritja varion edhe 30-45 minuta në stacione të ndryshme, siç është ai i kopështit zoologjik; Farka, Baldushku, Dajti etj.

Për këtë arsye, Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” filloi në muajin shtator 2022 një fushatë advokuese të kërkuar nga qytetarët për të sjellë në vëmendje të bashkisë adresimin e këtij prioriteti, me dy kërkesa kryesore:

1. Afishimin e orareve dhe stacioneve në vendqëndrimet e autobusëve
2. Shtimin e frekuencës së lëvizjes së transportit publik drejt dhe nga njësiti administrative më larg qytetit si Dajti, Farka, Baldushku etj.

Së bashku me grupet qytetare, u realizuan disa fushata në terren me mendimin qytetar sipas formës VOX POP; u monitoruan të gjitha vendqëndrimet e urbanëve pranë kësaj bashkie si edhe u përpilua një Peticion nga qytetarët drejtuar Këshillit Bashkiak të Tiranës dhe për dijeni kryetarit të bashkisë Tiranë, Z. Erion Veliaj.

Në bazë të takimeve, fushatave advokuese dhe ndjekjes së këtij prioriteti për tu përmbushur, për vitin 2024 Bashkia e Tiranës planifikon shumën prej 43,200,000 Lekë për projektin e monitorimit, menaxhimit dhe kontrollit të transportit publik qytetës, nëpërmjet sistemeve inteligjente të transportit (AVL), në nivel qendror dhe lokal, si dhe sistemeve të informacioneve në kohë reale për pasagjeret (RTIP), për disa nga stacionet kryesore.¹⁹

Gjetjet nga fokus-grupet me komunitetin Tiranë

Në të njëjtën kohë me monitorimin dhe mbledhjen e informacionit nga Bashkia Tiranë, GADC organizoi fokus-grupe diskutimi me komunitetin në njësi të ndryshme administrative të kësaj bashkie, njësi në të cilat dolën edhe prioritetet kryesore. Në bazë të komunikimeve dhe gjetjeve prej tyre, qytetarët kanë identifikuar disa ndryshime pozitive të cilat janë pjesë e Kontratës Sociale, por kishte edhe prioritete të cilat sipas tyre nuk janë adresuar siç duhet dhe do të ndiqen nën monitorimin e Kontratës Sociale 2023-2027. Një pasqyrë e gjetjeve të këtyre takimeve paraqitet si më poshtë vijon, e ndarë sipas Njësive Administrative:

Njësia Administrative nr. 1²⁰

- Akoma nuk është ndërtuar apo caktuar një hapësirë për një bibliotekë, e cila mund të ishte një burim i rëndësishëm për zhvillimin kulturor dhe arsimor të komunitetit.
- Ka pasuar rikonstrukcion të disa rrugëve, ndërsa disa të tjera janë ende nën rikonstrukcion. Ky është një hap pozitiv dhe vlerësohet nga komuniteti, por mund të ketë nevojë për vazhdimin e këtyre përpjekjeve.
- Është realizuar kërkesa për ndërtimin e një çerdheje, duke u adresuar nevojat e familjeve dhe përmirësuar kujdesin ndaj fëmijëve të komunitetit.
- Megjithatë, nuk janë realizuar ende përmirësime të rrjeteve të ujërave të zeza, çka mund të sjellë sfida për banorët dhe infrastrukturën e përgjithshme.
- Ka disa përfitues të subvencionimit të qerave, por është e rëndësishme të monitorohet për të siguruar se ky program përfiton ata që kanë më shumë nevojë.

¹⁹ Projekt buxheti Bashkia Tiranë 2024: <https://tirana.al/kategoria-e-publikimit/2023-2141>

²⁰ Fokus Grup Diskutimi: <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-qytetare-e-nj-a-nr-1-tirane/>

- Nuk janë afishuar ende oraret në stacionet e autobusëve, çka vijon të shkaktojë vështirësi për udhëtarët dhe të ngadalësojë lëvizjen në zonë.
- Për çështjet e mjedisit, pastrimi i rrugëve, parqeve dhe mbetjeve urbane vlerësohet si mesatar. Mund të konsiderohen masa shtesë për të përmirësuar këtë aspekt të cilësisë së jetës së përditshme.
- Nuk ka pasur një rritje të orareve të furnizimit me ujë të pijshëm, duke lënë hapësirë për përmirësime në disponueshmërinë dhe aksesin në ujë të pijshëm.

Njësia Administrative nr. 2²¹

- Banorët e njësisë shprehin një vlerësim pozitiv për informimin nga Njësitë Administrative, por vërejnë vonesa në komunikim nga bashkia, veçanërisht në lidhje me ankesat ose kërkesat për informacion.
- Shqetësimet lidhur me mbipopullimin e kopshteve në këtë njësi vazhdojnë për gjyshet dhe gjysherit, të cilët regjistrojnë fëmijët e tyre në kopshtet e lagjeve.
- Megjithë funksionalitetin e qendrave të Shkozës dhe Multidisiplinare, të moshuarit hasin vështirësi në përdorimin e tyre për shkak të largësisë, prandaj kërkojnë një qendër më pranë njësisë administrative.
- Problematika me mungesën e ujit të pijshëm vazhdon edhe këtë vit, duke sjellë orar të caktuar dhe mungesë.
- Banorët vijnë të blejnë ujë nga shitësit ose marketet për shkak të mungesës së ujit të pijshëm dhe disponueshmërisë së tij sipas orarit.
- Banorët konfirmojnë se personat në nevojë, invalidët dhe pensionistët e vetmuar përfitojnë ulje taksash në faturën e ujit dhe të dritave.
- Numri i kopshteve dhe shkollave është i mjaftueshëm dhe godinat e tyre janë të restauruara. Megjithatë, banorët kërkojnë shtimin e shërbimit “after school” tek shkollat e zonës.

Njësia Administrative nr. 3²²

- Në këtë njësi, informacioni nga Njësia Administrative vlerësohet pozitivisht nga banorët e lagjeve të njësisë, ndërsa komunikimi nga bashkia përballë qytetarëve ka vonesa, veçanërisht në trajtimin e ankesave ose kërkesave për informacion.
- Furnizimi me ujë vazhdon të jetë një problem, sidomos në zonat si zona e burgut, ku mungon uji 24 orë dhe banorët përballen me sfida në sigurinë e ujit të pijshëm.
- Për shkak të largësisë, shumë banorë kanë vështirësi të frekuentojnë qendrën komunitare "Gonxhe Bojaxhiu".
- Një shqetësim tjetër i banorëve është papunësia dhe varesia nga Ndhima Ekonomike e marrë nga bashkia, e cila, sipas tyre, është shumë e ulët dhe nuk i përmirëson nevojat e tyre familjare, veçanërisht me rritjen e çmimeve të produkteve ushqimore.

²¹ Fokus Grup Diskutimi: <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-qtetaret-e-nj-a-nr-2-tirane/>

²² Fokus Grup Diskutimi: <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-qtetaret-e-nj-a-nr-3-tirane/>

- Vlerësohet mirembajtja e rrugëve në disa zona të caktuara të njesisë si në rrugët: Gjolek Kokona dhe Marie Logoreci. "
- Vlerësohet ndertimi i Shkollës 9-vjeçare "Xhezmi Delli".

Njësia Administrative nr. 4²³

- Informimi nga Njësia Administrative vlerësohet pozitivisht nga banorët e lagjeve në këtë njësi.
- Furnizimi me ujë 24 orë dhe çilesia e tij sillet si një problematikë që ka Akoma nevojë për vëmendje.
- Problematika në transportin publik në rrugën Allias - Kristal, me kërkesën që kjo linjë të trajtohet me prioritet.
- Infrastruktura në maloren e shkollës Bajram Curri, stacioni i karburantit tek Katrori, si dhe rruga Halil Bega.
- Mungon ndriçimi në disa rrugë të brendshme si tek Gjashta.
- Në kopshtin e fëmijëve nr. 25, banorët kërkojnë shtim të numrit të edukatorëve për shkak të shtimit të numrit të fëmijëve.
- Pastrimi nga kompanitë e pastrimit sipas banorëve nuk bëhet në mënyrë të rregullt dhe qentë e rrugës shkaktojnë shqetësime të mëdha për banorët.

Njësia Administrative nr. 5²⁴

- Në këtë njësi, ka nevojë për shërbime të shtuara për individët që i përkasin grupeve të marginalizuara, veçanërisht për familjet që mbështeten në Ndihmën Ekonomike.
- Çështja e ujit të pijshëm dhe cilësia e tij vazhdon të jetë një shqetësim i rëndësishëm për banorët e kësaj njësie
- Problematika me kanalizimet vazhdojnë të ekzistojnë në disa blloqe banimi, duke kërkuar përmirësime dhe zgjidhje për këtë çështje.
- Banorët shprehin kërkesën që Bashkia të ofrojë informacion dhe të konsultohet me ndërlidhësit kur bëjnë investime dhe punime, pasi ata janë në kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin dhe mund të sjellin perspektivën e tyre.
- Në lidhje me publikimin e datave të takimeve të Buxhetimit me Pjesëmarrje, banorët kërkojnë më shumë informacion për të qenë të informuar rreth procesit dhe vendimeve që ndikojnë në fushën e tyre.

Njësia administrative nr. 7²⁵

- Edhe pse transporti publik në Kombin funksionon rregullisht, problematika shfaqet në linjën e Ndroqit, ku autobusi urban lëviz vetëm një herë në orë.

²³ Fokus Gruo Diskutimi: <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-xytetaret-e-nj-a-nr-4-tirane/>

²⁴ Fokus Grup Diskutimi: <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-banoret-e-nj-a-nr-5-tirane/>

²⁵ Fokus Grup Diskutimi: <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-grate-e-nj-a-nr-7-tirane/>

- Është e nevojshme të riparohen rrugët e brendshme të lagjeve, të cilat janë në gjendje të amortizuar, dhe të përmirësohet ndriçimi nëpër lagje.
- Zona e Fushës së Aviacionit është bërë shumë e populluar dhe ka një sistemim të dukshëm në të gjithë zonën, por numri i kopshteve dhe çerdheve nuk është i mjaftueshëm për numrin e fëmijëve, veçanërisht nga ana e tyre që varet nga Ndihma Ekonomike.
- Banorët, sidomos ata që janë në varësi të Ndhmës Ekonomike, kërkojnë që bashkia të shqyrtojë mundësinë e punësimit të tyre në kohë të pjesshme, përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me biznese lokale.
- Për pensionistët e vetmuar dhe personat me Ndihmë Ekonomike janë hequr taksat e gjelbërimit dhe pastrimit.
- Banorët e vlerësojnë si shumë pozitiv lidhjen Ndërlidhës - Komunitet.
- Janë shtuar disa hapësira publike dhe ka ndërhyrje në disa rrugë si në “Naim Frashëri”, “Ban Rexhat Bardhi” ku janë shtuar edhe dy lulishte dhe dy terrene sportive.

Njësia Administrative nr. 8²⁶

- Në këtë njësi, problematika lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm është e prekshme, pasi uji vjen vetëm për dy orë në ditë dhe banorët shprehin keqardhje se cilësia e tij nuk është e duhur.
- Ekzistojnë disa linja të transportit publik në këtë njësi, por mungesa e orareve të afishuara bën që banorët të kenë vështirësi në monitorimin dhe organizimin e udhëtimeve të tyre.
- Pastrimi i rrugëve dhe koshave të mëdhenj kryhet rregullisht, megjithatë, një shqetësim është se këto pjesë nuk dizinfektohen, duke lejuar mbajtjen e mikrobeve dhe kërcënimin për shëndetin e publikut.
- Pensionistët ankohen për shërbimin e transportit publik, ku nuk lejohet që ata të udhëtojnë pa pagesë bilete. Kjo është një çështje e cila i ndikon ata në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke sjellë sfida dhe pasiguri në lëvizjen e tyre të përditshme.
- Banorët kërkojnë një rishikim të rritjes së ndihmës ekonomike që marrin, në mënyrë që të korrespondojë me rritjen e pagave. Ky shqetësim vjen nga nevoja për të siguruar një nivel më të mirë të mirëqënies për personat që janë në varësi ekonomike.

Njësia Administrative Baldushk²⁷

Mungesa e kopshteve dhe çerdheve me orare të plotë kufizon mundësinë e grave për tu punësuar. Ky është një shqetësim i rëndësishëm për familjet që duan të sigurojnë kujdesin e duhur për fëmijët e tyre ndërsa janë në punë.

- Në shkolla, banorët raportojnë mungesën e mesuesve për parashkollor, duke theksuar nevojën për rritjen e numrit të mesuesve për të siguruar një ambjent arsimor cilësor.
- Mungesa e ngrohjes gjatë dimrit në shkolla është një tjetër problem që ndikon shqetësueshëm ambjentin mësimor dhe komoditetin e nxënësve.

²⁶ Fokus Grup Diskutimi: <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-banoret-e-nj-a-nr-8-tirane/>

²⁷ Fokus Grup Diskutimi: <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-banoret-e-nj-a-baldushk/>

- Sherbimi veterinar dhe veterineri vazhdon të jenë të privatizuara, duke krijuar nevojë për një përfshirje më të mirë dhe koordinim nga ana e institucioneve përgjegjëse.
- Banorët shprehin nevojën për një ditë tregu në Baldushk për të promovuar dhe shitur produktet vendase. Kjo është një mënyrë për të nxitur ekonominë lokale dhe krijimin e mundësive për bizneset vendase.
- Rritja e popullsisë së të moshuarve të mbetur vetëm është një sfidë. Banorët kërkojnë shërbime dhe ndihmë për të kujdesur për këtë grup të popullsisë që nuk ka shërbime ose ndihmë të mjaftueshme.
- Gratë shprehin dëshirën për lehtësira dhe mbeshtetje për t'u punësuar në industrinë e prodhimit të veshjeve dhe këpucëve. Kjo ka për qëllim rritjen e përfshirjes së grave në sektorë të ndryshëm ekonomikë dhe shpërndarjen e mundësive të punës.

Njësia Administrative Dajt²⁸

- Mungesa e shërbimeve veterinare dhe një veterineri të kualifikuar në zonën e kësaj njësie paraqet një sfidë, pasi banorët janë të detyruar të përdorin shërbime private, duke krijuar nevojën për një përfshirje më të mirë dhe koordinim nga ana e autoriteteve lokale. Veterineri që u vendos para dy vitesh nga shteti nuk është më.
- Banorët vazhdojnë të kritikojnë mungesën e kopshteve dhe çerdheve për fëmijë, duke theksuar se kjo po penalizon gratë e zonës që janë në nevojë për punësim.
- Mungesa e raportimit të dhunës në familje nga zonat rurale është një çështje serioze, duke kërkuar nisma dhe programe për të adresuar dhe parandaluar këtë problem shoqëror.
- Zonat si Tufina (Poligoni), Priska dhe Brara raportojnë probleme me furnizimin e ujit të pijshëm, një çështje e cila mund të krijojë sfida të mëdha për banorët dhe duhet adresuar për të siguruar aksesin e tyre në burimet e ujit.
- Vonesat në transportin urban janë një çështje e vazhdueshme, me pritje në stacione nga 40 deri në 60 minuta, duke kërkuar përmirësime në oraret dhe frekuencën e autobusëve për të përmirësuar lëvizjen e banorëve.
- Banorët shprehin pikëpamjen se kompetencat e Administratorit të Njësisë Administrative duhet të shtohen, duke i dhënë atij më shumë përgjegjësi dhe mundësi për të trajtuar problemet dhe shqetësimet lokale.
- Pastrimi i rrugëve dhe lagjeve ndodh një herë në 5 ditë, një periudhë kohore që mund të shkaktojë probleme higjienike dhe estetike. Është e nevojshme të përmirësohet kjo shërbim për të siguruar një mjedis më të pastër dhe të sigurt për banorët.
- Kanalizimet e ujërave të zeza të bllokuara paraqesin një problem tjetër infrastrukturor, duke kërkuar riparime dhe mirëmbajtje të rregullt për të parandaluar mbylljen e tyre dhe shpërndarjen e rreziqeve mjedisore.

Njësia Administrative Farkë²⁹

²⁸ Fokus Grup Diskutimi: <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-banoret-e-nj-a-dajt-tirane/>

²⁹ Fokus Grup Diskutimi: <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-banoret-e-nj-a-farke-tirane/>

- Mungesa e kopshteve dhe çerdheve për fëmijë është një shqetësim i vazhdueshëm. Pavarësisht bisedave për ndërtimin e një kopeshti në Lunder, ende nuk ka informacion të qartë mbi fillimin e procesit ndërtues.
- Edhe pse janë kryer disa punime dhe permiresime në të gjithë njesinë administrative, përfshirë infrastrukturën dhe ndërtimin e Pallatit të Sportit, sfida me furnizimin e ujit vazhdon, ku uji vjen me orar dhe nuk është i mjaftueshëm.
- Sipas opinionit të banorëve, duhet shtuar forca punëtore për të mbajtur rruget në gjendje të mirë dhe për të kryer mirëmbajtjen e tyre.
- Pastrimi është rregulluar, por sfida mbetet në transportin urban, ku pritja në stacionin e urbanit vazhdon të jetë e zgjatur, duke ndikuar negativisht në lëvizjen e banorëve.
- Është e rëndësishme të shqyrtohen mundësitë për pako sociale më të zgjeruara për familjet në nevojë, duke përmirësuar ndihmën dhe mbështetjen për ato familje që përballen me kushtet e vështira ekonomike.
- Shkollat, në veçanti, kanë nevojë për bazë materiale të përhershme, veçanërisht për produkte higjienike si detergjentë dhe letra, për të siguruar një mjedis të pastër dhe të sigurt për nxënësit.
- Në pjesën Jug-Bathore, problemet e theksuara me furnizimin me ujë duhet adresuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe urgjente për të siguruar aksesin e banorëve në burimet e ujit në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurtë.

Përfundime dhe Rekomandime

Përgjatë katër viteve të monitorimit që Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim i ka bërë Kontratën Sociale dhe prioritetet e saj, kemi arritur pozitive dhe një angazhim të pushtetit vendor për të bashkëpunuar me shoqërinë civile për zërin qytetar. Pas monitorimit të vitit të katërt të monitorimit 85% e të gjitha prioritetet u adresuan nga bashkia e Tiranës, duke e bërë Kontratën Sociale pjesë të planeve të punës për secilën Njësi Administrative dhe drejtori përkatëse.

Në kontekstin e zgjedhjeve vendore të 14 Majit 2023, Rrjeti POP ka organizuar 16 Forume Publike³⁰ mes kandidatëve të forcave të ndryshme politike dhe qytetarëve. Në këto forume publike, Rrjeti POP ka prezantuar Kontratën Sociale 2023-2027 për secilën Bashki, një platformë që synon të mbështesë qytetarët në përcaktimin e prioritetet të tyre dhe të sigurojë angazhimin e kandidatëve për t'i ndjekur ato pas zgjedhjeve.

Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" ka hartuar Kontratën Sociale 2023-2027³¹, pas konsultimeve me qytetarët para zgjedhjeve dhe duke marrë parasysh prioritetet e ndjekura që nga viti 2019. Ky dokument është pranuar nga Bashkia Tiranë dhe u zyrtarizua me firmosjen e kryetarit të zgjedhur, z. Erion Veliaj.

Disa prej rekomandimeve dhe prioritetet kryesore të listuara edhe në Kontratën Sociale 2023-2027:

- Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor, nxitja e transparencës dhe llogaridhënies në administratën vendore për të përmirësuar besueshmërinë e institucioneve lokale.
- Drejtësia Sociale, përmirësimi i aksesit në shërbimet sociale, duke përfshirë kujdesin shëndetësor dhe shërbimet sociale për grupet në nevojë.
- Nxitja e Zhvillimit të qëndrueshëm vendor, implementimi i politikave dhe projekteve për promovimin e zhvillimit ekonomik dhe mjedisor të qëndrueshëm dhe përkrahja e sipërmarrjes vendore dhe inovacionit për të stimuluar zhvillimin e sektorëve lokalë.
- Transport publik i aksesueshëm dhe i sigurtë për të gjithë qytetarët e Tiranës, rritja e kapacitetit dhe kualitetit të transportit publik për të përmirësuar qasjen dhe sigurinë e udhëtarëve, investime në infrastrukturën e transportit publik për të lehtësuar lëvizjen dhe për të kujdesur për mjedisin, përmirësimi i shërbimeve të transportit për personat me nevoja të veçanta dhe përmirësimi i aksesit në transport për të gjithë qytetarët.
- Garantimi dhe aksesit në ujë të pijshëm dhe të konsumueshëm, sigurimi i sistemeve të furnizimit të ujit të pijshëm për të garantuar aksesin e përhershëm dhe cilësinë e ujit.
- Mirëmbajtja e Infrastrukturës rrugore, investime në mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e rrugëve për të përmirësuar sigurinë dhe efikasitetin e transportit rrugor.

³⁰ Buletini Informativ: https://popnetwork.al/buletin-informativ_maj-2023/

³¹ Kontrata Sociale POP Tiranë 2023-2027: <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-2023-2027-pop-tirane/>

- Rishikimi i planeve për Shkollat, Kopshtet dhe Çerdhet sidomos për zonat rurale, përmirësimi i kapacitetit dhe cilësisë së shkollave dhe institucioneve arsimore në zonat rurale, krijimi i mjedisit të sigurt dhe të përkrahur për zhvillimin e fëmijëve në mjedisin edukativ.
- Mbështetja e fermerëve në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme, krijimi i politikave dhe programeve mbështetëse për të përmirësuar kushtet e fermerëve dhe prodhimin lokal.
- Adresimi i Ndotjes Urbane përmes Politikave të Qëndrueshme të Energjisë, ndërtimi i politikave dhe strategjive për të zvogëluar ndotjen dhe përmirësuar cilësinë e ajrit në qytet.

Referenca

- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural <http://www.azhbr.gov.al/skema-kombetare-2022/>
- Faqja zyrtare e Bashkisë Tiranë <https://www.tirana.al/>
- Faqja zyrtare e Këshillit Bashkiak Tiranë <https://tirana.al/kategori/keshilli-bashkiak>
- Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë <https://www.facebook.com/ErionVeliaj>
- Faqja zyrtare e Rrjetit POP <https://popnetwork.al/>
- Fondi i Fuqizimit <https://tirana.al/artikull/projekti-i-bashkise-tirane-per-fondin-e-fuqizimit-te-te-rinjve-dhe-te-rejave>
- Kontrata Sociale Tiranë <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/07/Tirana-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>
- Open data bashkia Tiranë <https://opendata.tirana.al/>
- Plani i dytë i veprimit për Barazi Gjinore <https://tirana.al/artikull/plani-vendor-i-veprimit-per-barazine-gjinore-2022-2024>
- Raporti i vitit të dytë monitorues të Kontratës Sociale https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/06/Raporti_POP_Bashkia_Tirane-Viti-i-dyte.pdf
- Raporti i vitit të parë monitorues të Kontratës Sociale <https://popnetwork.al/raporti-nje-vjecar-kontrata-sociale-bashkia-tirane/>
- Raporti Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” Korrik 2022 <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/07/Raport-Bashkia-Tirane-2022.pdf>
- Takime me komunitetin <https://popnetwork.al/category/aktivitete-tirane/>
- Të dhëna mbi bibliotekat e Tiranës n<https://tirana.al/pikat-e-interesit/biblioteka>
- Ujësjellës Kanalizime Tiranë <http://ujesjellesitirane.al/>
- Vendime të Këshillit Bashkiak <https://tirana.al/kategoria-e-publikimit/2021-1130>
<https://tirana.al/kategoria-e-publikimit/2022-1134>

Fushata Advokuese e Transportit Publik

Fotografi nga vendqendrimet e autobusëve

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid05uL1pNBnLkLCGn2ZNwiCZFYvDL7s7m4jPFf7m2DpZ1S1xuF9a4hGPeV5r1PSt44Cl>

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid02QX65a9zTYBahFWx6XKU8R2b5A5b2vgGbSqnXTHg8DxSiNheFFWcVkdF526Ctnhtul>

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid0SNDx8xeRrwL5Cb5zRpE7q3TajA815fATiQ6haf2xuHPXGtMocYz6sFs7zR6MABofl>

<https://popnetwork.al/firmosni-peticionin-per-transportin-publik-te-ndermarre-nga-rrjeti-pop/>

<https://www.instagram.com/p/Ciht7qsDYQS/>

VOX POP

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid02EMgUaMgo8D7QtSBX4mth8avM63dxoJPVmycXvWAs3HdruMPqQDBDFKEWoXsN19TjI>

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid0X1s4HM5z1K6UX5AvDU2985X1AasZb46H1uRABSnQX5LFTsQztu4299mJ6AEohpkbl>

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid02r5cdi8svKDGR6RkWoEwvi5kQQkh337vJ2EhPUGz9rRHziGzu5fxBW1gUutsQ9aERl>

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid036NJSRyonnQTJ3WHXwLHXy5eRjXfGVP7CNHNaRbpsV2tpCsk6BJ5F8herfqjvZ3xml>

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid02hVWSB1AwryjN7HTvWgz4TWJweifbDwjPVvRcn61VcKUUY3tsAQNRWPZAbNyxnl>

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid02JVwfJzTshcSAmcsFsM7RNgiUhcXigJsCjLR3Tnu3miCeJ35Wx85P8KCxGA3evHx2I>

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid02RaFDweeFRdecisszFTTrLodjaiPPmLjxCPthsrmtvQJ8uH7uWm4Yhr31b3u1anr4I>

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid0TPxkXpV9gNStBTcGXc5EhC6Zzxy1jGZQRi12XJehVQfKXrrHeJ8fY3quUxHFEYfEI>

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/posts/pfbid0Xe1fzRuPJ7XUgxDiQLwUSWErPVCWMSFtRKit1yQyvot3DMtd8BDhC8t5BGYkhoL9I>

Anekse

Aneks 1. Kontrata Sociale e detajuar

KONTRATA SOCIALE PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE PRIORITETET E KOMUNITETIT BASHKIA TIRANË

Prioriteti 1: Shërbime veterinare në zonat rurale: Zgjerim i shërbimit veterinar në Njësitë Baldushk, Dajt dhe Farkë.

Prioriteti 2: Nxitja e biznesit të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël: Zgjerimi i programeve ekzistuese me fokus të rinjtë dhe gratë:

- Informimi i gjerë i grave dhe të rinjve mbi programet për nxitjen e biznesit dhe procesin e aplikimit për t'u përfshirë në këto programe.
- Rritje e buxhetit për start-upe për të rinjtë, i cili rrjedhimisht nënkupton rritje të numrit të përfituesve.
- Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës.
- Identifikimi i personave me aftësi të kufizuara, grave kryefamiljare apo vajzave-nëna dhe integrimi përmes këtyre incentivave.

Prioriteti 3: Mbështetja e fermerëve: Zhvillimi i programeve ekonomike që mbështesin fermerët. Njoftimi i tyre nga drejtoritë përkatëse në Njësitë Administrative dhe asistencë teknike dhe profesionale.

Prioriteti 4: Taksat bashkiake: Krijimi i lehtësive për tarifat e taksave bashkiake për kategoritë në nevojë si gra kryefamiljare, invalidët epunës, persona me aftësi ndryshe, vajza-nëna.

Prioriteti 5: Kopshtet dhe çerdhet: Ngritja e kopshteve dhe çerdheve të reja në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë, por sidomos në zonat rurale, në veçanti i çerdheve në Farkë dhe Dajt ku mungon plotësisht ky shërbim.

Prioriteti 6: Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë, në njësitë vijuese:

Të gjitha njësitë:

- *Ngritje e shërbimit rezidencial për të moshuarit.*
- *Trajtim me prioritet me strehim social të familjeve që jetojnë në bodrume dhe të grave të dhunuara.*

Njësia 2, 5, 7 dhe Farkë : Ngritja e një qendre komunitare për kategoritë në nevojë.

Njësia 3: Shmangia e vonesave në shpërndarjen e ndihmës ekonomike si dhe mbështetja me më shumë shërbime e familjeve me ndihmë ekonomike, në mënyrë të veçantë përmes strehimit social. Ngritja e një qendre ditore për të moshuarit.

Njësia 7: Zgjidhje afatgjatë e strehimit për banorët që preken nga projekti i Lanës dhe Unazës së Madhe.

Njësitë rurale: Krijimi i aksesit tek shërbimet sociale të ngritura nga Bashkia; Shërbime për moshën e tretë.

Prioriteti 7: Ngritja e shkollave të reja në Njësitë Administrative nr. 1, nr.2 (Në zonën e Depos së Ujit në rrugën “Budi”), nr.3, nr.5, nr.8 (në shkollën “Skënder Çaçi” vijon mësimi me dy turne dhe nga 33 veta në klasë) , Baldushk (ka fshatra që janë larg dhe fëmijët e kanë vështirë të shkojnë deri në qendër), Dajt (mungon shkolla e mesme, më e afërta është 1 orë larg). Planifikimi për të rregulluar sistemin e ngrohjes dhe të tualeteve në çdo shkollë 9-vjecare apo të mesme.

Prioriteti 8: Ngritja e bibliotekave të lagjes në Njësitë 1,3 dhe 5 si edhe në zonat rurale.

Prioriteti 9: Zgjerim i programeve ndërgjegjësuese në lidhje me dhunën në familje dhe pasojat e saj. Rritje e identifikimit të rasteve të dhunës në familje përmes punës proaktive në komunitet të strukturave të shërbimeve sociale; Forcimi i rrjetit të policimit në komunitet dhe ndërlidhsave me komunitetin. Zgjerim i shërbimeve ekzistuese mbrojtëse, fuqizuese dhe ri-integruese për viktimat e dhunës në familje.

Prioriteti 10: Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për secilën prej njërive vijuese:

Njësia 1: Zgjidhja e furnizimit me ujë, me prioritet zonat ku uji shkon vetëm 1 herë në ditë. Masa për të shmangur bllokimin e kanalizimeve.

Njësia 2: Prioritet rruga “Budi” ku uji vjen në orën 7 të darkës dhe ka vetëm dy orë. Gjithashtu, uji është i pakonsumueshëm. Zgjidhje për kanalizimet në këtë njësi (erë e padurueshme që vjen si pasojë e kanalizimeve të pa rregulluara.)

Njësia 3: Furnizim me ujë të pijshëm në të gjithë njësinë njësoj si në lagjen “Kodra e Priftit” që furnizohet me ujë pa ndërprerje. Ndërhyrje për kanalizimet veçanërisht në rrugët më problematike “Ali Bahushi”, “Kongresi i Manastrit” dhe “Kujtim Laro”.

Njësia 4: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. (Aktualisht furnizimi tre herë në ditë, më orare dhe nuk është i përdorshëm për t’u pirë.)

Njësia 5: Ndërhyrje tek Pallatet “Agimi”, në kufi me rrugën “Brigada e 8-të” ku tubacionet e ujit janë të vjetra.

Njësia 7: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. (Ujin e pijshëm banorët e blejnë.). Zgjidhja e rrjedhjes së ujrave të zeza para konvikteve të “Inxhinierisë së Ndërtimit”, ujëra që zbresin deri tek “Fusha e aviacionit”.

Njësia 8: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. Ndërhyrje në kanalizimet e rrugës “Ferit Xhajko”. (Pallati 59/8 vuan nga era e

padurueshme që vjen si pasojë e kanalizimeve të pa rregulluara. Problem ekzistues prej 30 vitesh.)

Njësia Baldushk: *Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. (Disa prej banorëve përdorin pusët e tyre. Uji që vjen nuk është i pijshëm.)*

Njësia Dajt: *Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit. (Nuk ka ujë të vazhdueshëm, vjen me orare, përdoren depozita edhe pse është zona e ujit të burimit, uji bëhet i pa pijshëm. S'ka furnizim 24 orë.)*

Njësia Farkë: *Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm dhe përmirësim i cilësisë së ujit me prioritet lagjia "Dina" dhe "Farkë e Vogël". Zgjidhje e problemit të derdhjes së ujërave të zeza në tokat e banorëve.*

Prioriteti 11: *Shtimi i autobuzëve në linjat e Njësive Administrative Baldushk, Dajt dhe Farkë. Publikimi në stacion i orareve të mbërritjes dhe nisjes së autobuzëve.*

Aneks 2 – Gjetjet Kryesore të Raportit të Vitit të Parë Monitorues

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Tiranë, të kryer nga Qendra "Alenca Gjinore për Zhvillim" më poshtë renditen disa nga gjetjet kryesore të dala nga ky monitorim për periudhën shtator 2019-shtator 2020.

- Në buxhetin e bashkisë Tiranë ka patur rritje për të rinjtë start-up, nga fondi 2.100.000 lekë me 20 përfitues dhe në fondin 5.000.000 lekë me 20 përfitues;
- Sipas Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, (AZHBR) nga data 29 maj deri 19 qershor 2020, fermerët kanë patur mundësinë të aplikojnë në e-Albania, me zero dokumente, për të përfituar nga fondet që jep buxheti i shtetit si mbështetje për sektorin bujqësor përmes Skemës Kombëtare 2020. Por, sipas takimeve me komunitetin, fermerët kryesisht janë vetfinancuar, nuk kanë bërë aplikime sepse ka shume kritere që sipas banorëve ata nuk kanë mundësi për ti plotësuar, konkretisht kërkohet sipërfaqe e madhe e tokës, të jetë me dokument pronësie etj;
- Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", ka njoftuar në mënyrë të vazhdueshme njësitë e qeverisjes vendore me përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar, megjithatë në dy prej njësive të zonave rurale komuniteti vijon kërkesën për shtim veterinerësh;
- Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.58 datë 26.12.2019 nuk janë parashikuar lehtësira për tarifën e taksave bashkiake për kategoritë në nevojë si gra kryefamiljare, apo vajza nëna.
- Gjatë periudhës monitoruese një vjeçare janë bërë disa ndërhyrje sa i përket çerdheve dhe kopshteve për fëmijë me rreth 8 godina të rikonstruara, ndërkohë që në njësitë administrative rurale nuk ka çerdhe dhe kopshtet janë pa ushqim;

- Ngritja dhe funksionimi i shërbimit rezidencial për të moshuar dhe persona që jetojnë në situatë rruge, target grup i vlerësuar si më vulnerabël, realizohet përmes Qendrës Sociale “Strehëza Tiranë”,
- Nga janari në qershor 2020, janë miratuar 2 vendime për përfitim Bonus Qiraje në Këshillin Bashkiak, ku janë shpallur fituese 41 gra,
- Është realizuar Inagurimi i Shërbimit Komunitar Lëvizës, Njësia Administrative Farkë në dhjetor 2019. Bashkia Tiranë në bashkëpunim me SOS Fshatrat në Shqipëri, kanë bashkëmodeluar dhe lancuar fillimin e ofrimit të shërbimeve lëvizëse sa më pranë familjes dhe anëtareve të komunitetit,
- Ndihma Ekonomike është dhënë brenda afatit të caktuar dhe nuk ka patur problematika apo ankesa nga përfituesit.
- Aktualisht, projekti më i ri që bashkia ka në qëllim për zbatim janë Klubet e Prindërimit, përmes të cilit, partnerë dhe ekspertë të fushës nga Save the Children, Terre des hommes, Eorld Vision dhe Bethany Social Services, do të mundësojnë module trajnime për prindërim pozitiv, duke shkuar pranë çdo komuniteti rural.
- Sa i përket shërbimeve për moshën e tretë në zonat rurale, Bashkia Tiranë është në proces të vlerësimit të aseteve të mundshme për të ngritur shërbime komunitare pranë zonave të ndryshme të njësive administrative rurale e në bazë të tyre të projektojnë shërbimet e përshtatshme e planifikojë strukturat enevojshme shërbimofruese.
- Lidhur me prioritetet sipas Kontratës Sociale përsa i përket ndërhyrjeve sipas njësive administrative nr. 1, nr. 2, nr.3, nr. 5 dhe nr. 8, janë kryer 4 tipologji ndërhyrjesh kryesore: Ndërhyrjet me rikonstruksion; Ndërtimet e reja në objektet shkollore; Ndërhyrjet me “Mirëmbajtje të thellë” në tualete; Në sistemin e ngrohjes qëndrore me kaldajë.
- Gjatë vitit të parë, pas firmosjes së Kontratës Sociale POP, nuk është ngritur asnjë bibliotekë e re. Kjo edhe për shkak të situatës së krijuar nga termeti dhe pandemia COVID-19 megjithatë Bashkia e Tiranës ka në fokus shtimin e numrit të bibliotekave.
- Që nga muaji Qershor 2020 përmes investimit të ri për zgjerimin e impiantit Bovillë dhe ndërtimit të linjave të reja të transmetimit është siguruar furnizim 24 orë për më shumë se gjysmën e kryeqytetit, në të cilën përfshihen plotësisht apo edhe pjesërisht disa njësi administrative. Sipas përlllogaritjeve të UKT-së, 62% e popullsisë së kryeqytetit ka aktualisht furnizim 24 orë në 24.
- Një prej prioritetëve të Kontratës Sociale ishte edhe shtimi i numrit të autobusëve sidomos për linjat e njësive administrative rurale Dajt, Baldushk dhe Farkë. Përballja me një situatë aspak të favorshme kjo për shkak të pandemisë COVID-19, ky prioritet nuk është përmbushur akoma.

Aneks 3 – Gjetjet Kryesore të Raportit të Vitit të Dytë Monitorues

- Me Vendimin e ri nr. 475, datë 31.7.2021, veterinerët zyrtarë janë nën varësinë e Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë. Bashkia Tiranë kryen vetëm monitorim të profilaksisë në bashkëpunim me strukturat e shërbimit veterinar rajonal.
- Në lidhje me nxitjen e biznesit tek të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël, ka patur rritje, mbështetje dhe bashkim projektësh. Projekti “Fuqizimi i të rinjve dhe të rejave” ka ardhur si rrjedhojë e bashkimit të dy projekteve: “Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni” me buxhet 5.000.000 Lekë dhe projektit “Biznesi Rinor” me buxhet 10.000.000 Lekë. Thirrja për këtë vit u shpall nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, nëpërmjet Drejtorisë së Nxitjes së Punësimit. Ndërkohë që, nuk ka rritje në numrin e përfituesve krahasuar me një vit më parë.
- Sipas monitorimit të kryer nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” gjatë vitit 2021, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural ka mbyllur thirrjen për aplikim në datë 25 Janar 2021 për fondet e programit IPARD 2, me një shumë financimi prej 30 mln Euro me 360 aplikime në total. Ndërkohë, sa i përket Skemës Kombëtare për mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga buxheti i qeverisë shqiptare, gjatë vitit 2021 ishin 54 përfitues në total, ndryshe nga një vit më parë ku numri i përfituesve ishte 94.
- Sa i përket taksave bashkiake, krijimi i lehtësive për kategoritë në nevojë si gra kryefamiljare, invalidë të punës, persona me aftësi ndryshe, vajza-nëna, mbetet njësoj si një vit më parë pa ndonjë lehtësi të dukshme. Sipas banorëve, janë hequr taksat vendore për kategoritë në nevojë (taksat e përfshira në faturën e ujit), ndërsa personat me aftësi të kufizuar dhe invalidët e punës, përfitojnë nga heqja e taksës vetëm nëse familjarët e tyre janë të papunë.
- Çerdhet dhe kopshtet e fëmijëve, edhe këtë vit kanë marrë një vëmendje të veçantë nga Bashkia Tiranë, duke hapur dyert e 8 çerdheve dhe kopshteve në të gjithë territorin e bashkisë. Gjithashtu, këtë vit në Njësinë Administrative Dajt është hapur shërbim i ri i çerdhes dhe i kopshtit me kapacitet 200 fëmijë.
- Bashkia Tiranë njësoj si një vit më parë vijon me ofrimin e shërbimit rezidencial për të moshuar dhe persona që jetojnë në situatë rruge, target-grup i vlerësuar si më vulnerabël, përmes Qendrës Sociale “Strehëza Tiranë”
- Në bashkinë e Tiranës aktualisht po zbatohen 2 projekte për të moshuarit në bashkëpunim me OSHC-të, projekti me titull: “Nuk je vetëm!” (Asistencë shtëpiake për të moshuarit në nevojë), nga ku do të jenë përfitues 35 të moshuar dhe projekti me titull: “Shërbimi multidisiplinar në banesë për të moshuarit në nevojë dhe të vetmuar, në bashkinë Tiranë”, ku ka përfitues edhe nga Njësitë Administrative Dajt, Zall-Herr, Sauk, Baldushk, Ndroq, Kashar, Farkë, Selitë, Vaqarr.
- Gjatë periudhës Janar – Shtator 2021 numri total i aplikimeve të programit social “Subvencionimi i qirasë” për kategoritë e kryefamiljareve me fëmijë, vajza-nëna/gra të dhunuara me Urdhër Mbrojtje apo gra të divorcuara, ishte 144 aplikime. Numri i përfituesve nga ky program social është 69.

- Në përmbushje të funksioneve të njërive të vetqeverisjes vendore në qendrat komunitare të Bashkisë Tiranë si “Të Qëndrojmë së Bashku”, “Gonxhe Bojaxhi”, “Qendra Komunitare Multidisiplinare” dhe “Qendra Komunitare Shkozë”, është rritur numri i përfituesve për shkak të rritjes së kohëzgjatjes të shërbimit ditor përgjatë gjithë ditëve të javës, pra, shërbime 08:00 – 20:00 nga e hëna në të premte dhe të shtunën 09:00-14:00.
- Përgjatë periudhës Shtator 2020- Shtator 2021, janë miratuar 11 Vendime të Këshillit Bashkiak me 319 përfitues të "Subvencionimit të qirasë" dhe 1 Vendim i Këshillit Bashkiak me 806 përfitues të “Subvencionimit të interesave të kredisë”. Ndër to janë shpallur përfituese (të dy programeve së bashku) 566 gra, nga të cilat 5 janë të mbijetuara të dhunës në familje.
- Gjatë vitit të parë monitorues Bashkia e Tiranës realizoi ndërhyrje dhe rikonstrukcion në 12 shkolla në territorin e saj, ku u përfshinë Njësitë Administrative Baldushk; Dajt; 1, 2, 3, 5 dhe 8. Gjatë periudhës së monitorimit Shtator 2020 – Shtator 2021 dhe bazuar në monitorimin e GADC-së dhe në informacionin e marrë nga Bashkia Tiranë, janë rindërtuar 6 shkolla. Gjithashtu, janë ndërtuar nga e para dhe kanë hapur dyert për nxënësit në Shtator 2021 edhe 2 shkolla të tjera. Ndërkohë që, aktualisht Bashkia Tiranë ka planifikuar edhe ndërtimin e 4 shkollave të tjera, të cilat do të jenë gati dhe funksionale brenda vitit 2022.
- Ndërkohë, gjatë vitit 2021 në kuadër të projektit "Bibliotekat e lagjeve si qendra multifunkionale", Bashkia Tiranë ka inauguruar hapjen e dy bibliotekave të rikonstruara, përkatësisht biblioteka "Moikom Zeqo" në rrugën "Tefta Tashko Koço", Njësia Administrative nr.2 si edhe biblioteka "Valter Gjoni" në rrugën "Lord Bajron" pranë Njesisë Administrative nr. 11.
- Vitet e fundit janë zgjeruar programet dhe aktivitetet ndërgjegjësuere rreth dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore. Ndryshe nga një vit më parë ku për shkak të situatës së pandemisë COVID-19 numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere ishte relativisht i ulët, këtë periudhë monitorimi Bashkia Tiranë ka zgjeruar gamën e aktiviteteve edhe në terren.
- Gjatë periudhës monitoruese, Bashkia Tiranë ka trajtuar 1272 raste të dhunës me bazë gjinore dhe në familje gjatë mbledhjeve të ETN-së me anëtarë të MKR-së Tiranë, në bashkëpunim me Njësitë Administrative dhe Qendrat Komunitare.
- Sipas informacioneve zyrtare të përfuara nga Ujësjellës Kanalizime Tiranë, viti 2021 ka një rritje me 10% të mbulimit me ujë 24 orë. Në vitin 2020, sipas UKT, Tirana mbulohej në 60% të territorit me ujë pa ndërprerje, ndërsa në vitin e dytë monitorues mbulohet 70% e territorit të Tiranës me ujë 24 orë.
- Sa i përket sigurisë së ujit të pijshëm, shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sh.a. është në monitorim të vazhdueshëm nga institucionet kompetente, për zbatimin rigoroz të plotësimit të kushteve higjieno – sanitare të puseve dhe stacioneve të pompimit, përcaktuar në “Direktivën e Këshillit të Europës 98/83/EC, datë 03.11.1998, mbi cilësinë e ujit për konsum njerëzor” dhe rregulloren “Cilësia e ujit të pijshëm” miratuar me Vendimin nr.379, datë 25.05.2016 të Këshillit të Ministrave. Shoqëria UKT sh.a. garanton se, uji që del nga depot dhe furnizon rrjetin e shpërndarjes është brenda parametrave të kërkuar dhe është totalisht i sigurtë.

- Viojnë problematikat me transportin publik përsa I përket kohës së pritje në stacionet e linjave rrethqytetese dhe mungojnë afishimet e orareve në stacionet pritëse.

Aneks 4 – Gjetjet Kryesore të Raportit të Vitit të Tretë Monitorues

- Në njësinë administrative Baldushk është i nevojshëm zgjerimi i shërbimit veterinar. Në njësinë administrative Farkë ky shërbim është realizuar pranë mjediseve të njësisë me anë të afishimit të kontaktit të veterinerit të zonës. Ndërkohë që kjo problematikë ka dy vjet që është zgjidhur në Njësinë Administrative Dajt.
- Për nxitjen e biznesit të rinjtë, gratë dhe grupet vulnerabël, Bashkia Tiranë nëpërmjet Drejtorisë së Nxitjes së Punësimit, për vitin 2021-2022 ka zbatuar dy projekte: “Fuqizimi i të rinjve dhe të rejave” dhe “Fuqizimi i Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes”
- Gjatë periudhës 2021-2022, Drejtoria e Nxitjes së Punësimit pranë bashkisë Tiranë bashkoi dy programe në një të vetëm. Mbështetje më të lartë granti deri në 800,000 lekë për subjekt për 18 përfitues për një periudhë zbatimi 12 mujore.
- Në programet që drejtoria zbaton, numri i grave të mbështetura me grante është 56 (pesëdhjetë e gjashtë), të cilat i kanë bizneset aktive. Numri i Personave me Aftesi të Kufizuar është 2 (dy) subjekte aktive.
- Gjatë periudhës Shtator 2021 - Shtator 2022, Bashkia Tiranë ka përfunduar rindërtimin dhe rikonstruksionin e plotë të një kopshti ekzistues. Gjithashtu ka përfunduar ndërtimi i 6 kopshteve të reja, për vitin shkollor 2022-2023, të cilat i shtohen numrit të kopshteve publike të qytetit të Tiranës.
- Është rinovuar marrëveshja e bashkëpunimit me Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, për ngritjen e shërbimeve për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi, neglizhimi, dhuna dhe shfrytëzimi në Tiranë, por dhe të rinjtë dhe gratë, nëpërmjet një qendre komunitare multidisiplinare, me shërbime specifike si Shërbimi i emergjencës 72 orë dhe Shkolla e lëvizshme, në Njësinë Administrative 7.
- Gjatë periudhës Shtator 2021- Shtator 2022, numri total i aplikimeve të programit social "Subvencionimi i qirasë" për kategoritë e kryefamiljareve me fëmijë, vajza-nëna/gra të dhunuara, me Urdhër Mbrojtjeje apo të divorcuara, ishte 120 aplikime. Numri i përfituesve nga ky program social është 45.
- Përgjatë periudhës Shtator 2021-Shtator 2022 janë miratuar 9 Vendime të Këshillit Bashkiak “ Subvencionim i qirasë”, ku përfituan 78 gra kryefamiljare me fëmijë në ngarkim dhe gjithashtu edhe 7 të mbijetuara të dhunës në familje.
- Në përfitim të shërbimeve sociale në mbarë territorin e qytetit të Tiranës, Bashkia Tiranë në janar të vitit 2022 ka ngritur Njësitë e Vlerësimit dhe Referimit të Rastit në 27 njësitë administrative dhe Lagjet e Tiranës.
- Gjatë periudhës Shtator 2021 - Shtator 2022, Bashkia Tiranë ka përfunduar rindërtimin dhe rikonstruksionin e plotë të 4 shkollave. Gjithashtu ka përfunduar ndërtimi i 8 shkollave për vitin shkollor 2022-2023, cilat i shtohen numrit të shkollave publike të qytetit të Tiranës

- Aktualisht në vitin 2022 në territorin e bashkisë Tiranë janë 7 biblioteka të lagjeve të hapura për publikun sipas njësive administrative.
- Mekanizimi i Koordinuar i Referimit (MKR) Tiranë ka arritur të trajtojë 1465 raste të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- Në datë 12 korrik 2022, bashkia e Tiranës miratoi Planin e Dytë Vendor të Veprimit për Barazi Gjinore
- Ndërkohë sa i përket përmirësimit të rrjetit të kanalizimeve apo rikonstruksioneve të rrjetit të ujit të pijshëm, sipas monitorimit të kryer nga GADC, rezultojnë disa ndërhyrje pozitive të ndërmarra gjatë vitit 2022 dhe që adresojnë kërkesat e qytetarëve sipas Kontratës Sociale.
- Sa i takon afishimit të orareve në stacionet e linjave, aktualisht ato janë të afishuara në stacionin e nisjes për linjat me nisje tek fusha pranë Fakultetit Ekonomik. Aktualisht po ndiqet projekti për informatizimin e stacioneve të linjave rreth qendrës së qytetit, dhe në vijim do të shikohet mundësia për më gjerë.

Aneks 5 – Vendimet e Këshillit Bashkiak në lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale

Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë

Shtator 2022

01.09.2022

Vendimi: PËR EMËRTIMIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE PUBLIKE

06.09.2022

Vendimi: PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 166, DATË 24.12.2021, TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2022-2024 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2022, TË NDRYSHUAR

Facebook video link: <https://fb.watch/obkriYMOc0/>

27.09.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIUDHËN 1-31 GUSHT 2022

Prioriteti nr. 6

Linku: https://tirana.al/uploads/2022/10/20221003090415_vendim-nr-79-dt-279-2022-bllok-ndihma-ekonomike-gusht-2022.doc

Tetor 2022

10.10.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E AKT – MARRËVESHJES TIP PËR PËRFITIMIN E TRAJTIMIT PËRMES FONDIT TË BANESAVE NGA POSEDUESIT E NDËRTIMEVE PA LEJE QË NUK LEGALIZOHEN

Prioriteti nr. 6 – ka lidhje me subjektet e prekura nga projekti i Unazës së Madhe

Link: https://tirana.al/uploads/2022/10/20221014162922_vendim-nr-84-date-10102022-per-miratimin-e-akt-marrveshjes-per-perfitim-trajtim-unaza.doc

19.10.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE, 2022-2024, PËR BASHKINË TIRANË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/10/20221027142330_vendimi-87.zip

19.10.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL SOCIAL PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, 2022-2024, PËR BASHKINË TIRANË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/10/20221027142647_vkb88.zip

19.10.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2022-2024, PËR BASHKINË TIRANË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/10/20221027143004_vkb-89.zip

19.10.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT 5 - VJEÇAR TË STREHIMIT 2022-2027, NË BASHKINË E TIRANËS

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/10/20221027143415_vkb-90.zip

19.10.2022

Vendimi: PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR 15 (PESËMBËDHJETË) FAMILJE QË KANË PËSUAR DËME NDËRTIMORE DHE NË ORENDI/PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE SI PASOJË E ZJARRIT DHE PËRMBYTJEVE, DËMET NDËRTIMORE NË AMBIENTET E PËRBASHKËTA TË NDËRTESËS NR. 36 (SIPAS ADRESARIT TË RI), NË RRUGËN “KASTRIOTËT”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 11 DHE KORRIGJIMIN E GABIMEVE MATERIALE NË VENDIMIN NR. 68, DATË 12.07.2022, TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR 9 (NËNTË) FAMILJE QË KANË PËSUAR DËME NDËRTIMORE DHE NË ORENDI/PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE SI PASOJË E ZJARRIT DHE PËRMBYTJEVE

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/10/20221027144902_vendim-nr-92-dt-19-10-2022-per-dhenien-e-ndihmes-financiare-15-familje.doc

19.10.2022

Vendimi: MBI TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË, QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË, SI DHE PËR NJË KORRIGJIM NË VENDIMIN NR. 61 DATË 06.07.2022 TË KËSHILLIT BASHKIAK

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/10/20221028101250_vkb-93.zip

19.10.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT TË LIRË, TË INDIVIDËVE/FAMILJEVE, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA SHPRONËSIMI PËR INTERES PUBLIK, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, ME QËLLIM REALIZIMIN E PROJEKTEVE “PËR ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 6, ZONA “KOMBINAT” DHE NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 4 DHE 8, ZONA “5 MAJI

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/10/20221027145644_vkb-94.zip

19.10.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË” NË BASHKINË E TIRANËS

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/10/20221027150203_vkb-96.zip

19.10.2022

Vendimi: PËR RIORGANIZIMIN E SHOQËRISË UKT SH.A NË KUADËR TË POLITIKAVE KOMBËTARE PËR RIORGANIZIMIN E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT, TRAJTIMIT DHE PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Prioriteti nr. 10

Link: https://tirana.al/uploads/2022/10/20221027152052_vendim-nr-99-dt-19-10-2022-per-riorganizimin-e-ukt.doc

24.10.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIUdhËN 1-30 SHTATOR 2022

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/10/20221027153727_vendim-nr-104-dt-24-10-2022-bllok-ndihma-6-per-qind-shtator-2022.doc

Nëntor 2022

15.11.2022

Vendimi: PËR PËRFITUESIT NGA GRANTI I RIKONSTRUKSIONIT

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/11/20221124123008_desktop.zip

15.11.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË PËRFITUESVE TË PROGRAMEVE TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/11/20221124123059_desktop.zip

22.11.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIU DHËN 1-31 TETOR 2022

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/11/20221124123537_vendim-nr-120-date-22112022-bllok-ndihma-6-per-qind-tetor-2022.doc

Dhjetor 2022

19.12.2022

Vendimi: MBI TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË, QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2022/12/20221223093722_desktop.zip

23.12.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIU DHËN 1-30 NËNTOR 2022

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/1/20230104135932_vendim-nr124-date-23122022-6-perqind-ntor-2022.doc

23.12.2022

Vendimi: PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 96, DATË 19.10.2022 TË KËSHILLIT BASHKIAK "PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË" NË BASHKINË E TIRANËS

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/1/20230104141313_desktop.zip

23.12.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN NË PARIM TË "PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZHVENDOSJE", SI PASOJË E ZBATIMIT TË PROJEKTIT "SHTRATI I LUMIT LANA – ZHVILLIM URBAN

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/8/20230822124543_vendim-nr134-date-23122022-plani-i-ndikimit-te-zhvendosjes.doc

23.12.2022

Vendimi: PËR KRIJIMIN E QENDRËS KOMUNITARE “PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA” SI INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË TIRANË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/1/20230104141933_vendim-nr135-date-23122022-krijimi-i-qendres-pak.docx

23.12.2022

Vendimi: PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË TRAJTIMIT FINANCIAR NË FORMËN E BONUSIT TË QIRASË TË INDIVIDËVE/FAMILJEVE, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TË SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA E MADHE E TIRANËS, SHESHI SHQIPONJA – BULEVARDI I RI, SHKOZË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/1/20230104142048_vendim-nr136-date-23122022-trajtimi-financiar-familje-unaza.docx

23.12.2022

Vendimi: PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.158, DATË 26.12.2019, TË KËSHILLIT BASHKIAK, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS”, TË NDRYSHUAR

Prioriteti nr. 4 (shpjegon kategoritë e përjashtuara nga taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore)

Link: https://tirana.al/uploads/2023/1/20230104143417_desktop.zip

Janar 2023

25.01.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2022

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/2/20230217124653_desktop.zip

25.01.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË PËRFITUESVE TË PROGRAMEVE TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/2/20230217131102_desktop.zip

25.01.2023

Vendimi: PËR PËRFITUESIT NGA GRANTI I RIKONSTRUKSIONIT

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/2/20230217130904_desktop.zip

25.01.2023

Vendimi: PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E LISTAVE TË PËRFITUESVE NGA PROGRAMET E RINDËRTIMIT

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/2/20230217131554_desktop.zip

25.01.2023

Vendimi: PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 10 DATË 05.02.2020 "PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË STREHIMIT 'SUBVENCIONIMI I QIRASË'"

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/2/20230217132052_vendim-nr-7-date-2512023-per-disa-shtesa-dhe-ndryshime-ne-vendimin-nr-10-date-05022020.doc

25.01.2023

Vendimi: PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË, QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/2/20230217132150_desktop.zip

25.01.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E VËNIES NË FUNKSION TË SHËRBIMIT ME KOHË TË PLOTË DHE USHQIM, TË ÇERDHE DHE KOPSHTIT TË INTEGRUAR, "ÇERDHE DHE KOPSHT KEI", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.7

Prioriteti nr. 5

Link: https://tirana.al/uploads/2023/2/20230217132230_vendim-nr-9-date-2512023-per-venien-ne-funksion-te-cerdhe-dhe-kopesht-kei.doc

Shkurt 2023

23.02.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIU DHËN 1-31 JANAR 2023

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/3/20230303100832_vendim-nr15-date-2302-2023-6-janar-2023.doc

28.02.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, QË PËRFITOJNË BURSA DHE PAGESA, PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023

Mars 2023

17.03.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR OSE FONDIT TË BUXHETIT VENDOR, MBI PROGRAMIN E BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND PËR VITIN 2023

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/3/20230331125819_vendim-nr17-date-17032023-miratimi-i-kriterëve-te-6-per-vitin-2023.doc

17.03.2023

Vendimi: PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR 18 (TETËMBËDHJETË) FAMILJE QË KANË PËSUAR DËME NDËRTIMORE DHE NË ORENDI/PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE SI PASOJË E ZJARRIT DHE PËRMBYTJEVE SI DHE KORRIGJIMIN E GABIMEVE MATERIALE NË VENDIMIN NR. 128, DATË 23.12.2022, TË KËSHILLIT BASHKIAK "PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR 16 (GJASHTËMBËDHJETË) FAMILJE QË KANË PËSUAR DËME NDËRTIMORE DHE NË ORENDI/PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE SI PASOJË E ZJARRIT DHE PËRMBYTJEVE, DHE DËMET NDËRTIMORE NË AMBIENTET E PËRBASHKËTA TË PALLATIT "MESAPLIK 05", NDËRTESA NR. 4, NË RRUGËN "MIGJENI", LAGJIA NR. 14

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/3/20230331130157_vendim-nr18-date-17032023-per-dhenien-e-ndihmes-per-18-familje.doc

17.03.2023

Vendimi: PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË, QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/4/20230403083028_desktop.zip

17.03.2023

Vendimi: PËR SISTEMIMIN E ZNJ. FLUTURA STAFIA NË BANESAT SOCIALE ME QIRA, SHKOZË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/3/20230331132355_vendim-nr29-date-17032023-banese-sociale-fstafa.doc

17.03.2023

Vendimi: PËR SISTEMIMIN E Z. MARSEL QELESHI NË BANESAT SOCIALE ME QIRA, SHKOZË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/3/20230331132429_vendim-nr30-date-17032023-per-sistemim-banese-mqeleshi.doc

17.03.2023

Vendimi: PËR SISTEMIMIN E ZNJ. ZANA SEFERI NË BANESAT SOCIALE ME QIRA, SHKOZË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/3/20230331132458_vendim-nr31-date-17032023-per-sistemimin-banese-zseferi.doc

27.03.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIU DHËN 1-28 SHKURT 2023

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/3/20230331132726_vendim-nr33-date-27033023-6-shkurt-2023.doc

Prill 2023

19.04.2023

Vendimi: PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË, QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/5/20230508150948_desktop.zip

19.04.2023

Vendimi: PËR PËRCAKTIMIN E QIRASË SIPAS STRUKTURAVE TË APARTAMENTEVE, TË VLERËS MAKSIMALE E MINIMALE TË TË ARDHURAVE DHE SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRFITUESIT E BANESAVE SOCIALE ME QIRA, NË KUADËR TË PROJEKTIT “NDËRTIMI I BANESAVE ME QËLLIM SOCIAL, NË ZONËN E SHKOZËS, ISH FONDERIA MEKANIKE

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/5/20230508151131_vendim-nr35-date-19042023-per-percaktimin-e-qirase-dhe-sistemin-e-pikezimit.doc

19.04.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT TË LIRË, TË INDIVIDËVE/FAMILJEVE, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA SHPRONËSIMI PËR INTERES PUBLIK, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, ME QËLLIM REALIZIMIN E PROJEKTEVE “PËR ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 6, ZONA “KOMBINAT” DHE NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 4 DHE 8, ZONA “5 MAJI

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/5/20230508151258_desktop.zip

19.04.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË TË INDIVIDËVE/FAMILJEVE, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TË SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA E MADHE E TIRANËS, SHESHI SHQIPONJA – BULEVARDI I RI, SHKOZË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/5/20230508151412_desktop.zip

19.04.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E VËNIES NË FUNKSION TË SHËRBIMIT ME KOHË TË PLOTË DHE USHQIM TË ÇERDHEVE ME VENDNDODHJE NË LAGJEN NR. 14 DHE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NDROQ

Prioriteti nr. 5

Link: https://tirana.al/uploads/2023/5/20230508152139_vendim-nr44-date-19042023-per-miratimin-e-hapjes-se-cerdheve.doc

24.04.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIUdhËN 1-31 MARS 2023

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/5/20230508152528_vendim-nr46-date-24-04-2023-6-mars-2023.doc

Maj 2023

03.05.2023

Vendimi: PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR 7 (SHTATË) FAMILJE QË KANË PËSUAR DËME NDËRTIMORE DHE NË ORENDI/PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE SI PASOJË E ZJARRIT, TËRMETIT DHE PËRMBYTJEVE

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/5/20230515124649_vendim-nr-51-date-03052023-per-dhenien-e-ndihmes-financiare-per-7-familje.doc

03.05.2023

Vendimi: PËR SISTEMIMIN E ZNJ. ALEKSANDRA META NË BANESAT SOCIALE ME QIRA, SHKOZË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/5/20230515124830_vendim-nr-53-date-03052023-per-sistemimin-e-aleksandra-meta-ne-banesat-sociale-me-qira.doc

09.05.2023

Vendimi: PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË, QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/5/20230515125135_desktop.zip

09.05.2023

Vendimi: PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 142, DATË 19.11.2021, TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS SË SHORTEUT PUBLIK DHE TË HAPUR, NË KUADËR TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/5/20230515125402_vendim-nr-55-date-09052023-per-nje-ndryshim-ne-rregulloren-e-shorteut-te-rindertimit.doc

09.05.2023

Vendimi: PËR PËRFITUESIT NGA PROGRAMET E PROCESIT TË RINDËRTIMIT

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/6/20230606141715_desktop.zip

23.05.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIUdhËN 1-30 PRILL 2023

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/6/20230627114513_vendim-nr62-date-23052023-bllok-ndihma-ekonomike-6-prill-2023.doc

31.05.2023

Vendimi: PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË, QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/6/20230605134910_desktop.zip

31.05.2023

Vendimi: PËR SISTEMIMIN E ZNJ. ESMA TULJA NË BANESAT SOCIALE ME QIRA, SHKOZË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/6/20230605135005_vendim-nr-65-date-31052023-per-sistemimin-e-shtetatses-e-t-ne-banesat-sociale.doc

Qershor 2023

13.06.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË TË INDIVIDËVE/FAMILJEVE, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TË SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA E MADHE E TIRANËS, SHESHI SHQIPONJA – BULEVARDI I RI, SHKOZË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/6/20230627114927_desktop.zip

20.06.2023

Mbledhja e konstituimit të Këshillit të ri Bashkiak të Tiranës

Facebook link: <https://fb.watch/ob9fWSWoe8/>

Korrik 2023

05.07.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIU DHËN 1-31 MAJ 2023

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/7/20230731112653_vendim-nr75-date-05072023-per-miratimin-e-blok-ndihmes-6.doc

20.07.2023

Vendimi: PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË, QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/7/20230731120433_desktop.zip

20.07.2023

Vendimi: PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR 29 (NJËZET E NËNTË) FAMILJE QË KANË PËSUAR DËME NDËRTIMORE DHE NË ORENDI/PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE SI PASOJË E ZJARRIT, TËRMETIT DHE PËRMBYTJEVE

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/7/20230731120602_vendim-nr86-date-20072023-per-dhenien-e-ndihmes-financiare-per-29-familje.doc

Shtator 2023

15.09.2023

Vendimi: PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIU DHËN 1-30 QERSHOR DHE 1-31 KORRIK 2023

Prioriteti nr. 6

Link: https://tirana.al/uploads/2023/9/20230928101816_vendim-nr90-date-15092023-per-miratimin-e-blok-ndihmes-ekonomike-6-qershor-2023.doc

Aneks 6 – Peticioni i qytetarëve dorëzuar në bashkinë Tiranë datë 13.10.2022

Model i deklaratës së angazhimit të mbledhësit të nënshkrimeve

DEKLARATË E ANGAZHIMIT TË MBLEDHËSIT TË NËNSHKRIMEVE PER PETICION

Drejtuar : Këshillit të Bashkisë Tirane

Unë i nënshkruari (emër, atësi, mbiemër) Emeralda Rexhep Hoxha
edatë lindjes 04/10/1980, deklaroj nën përgjegjësinë time personale se para nënshkrimit
të kësaj deklarate kam marrë dijeni për detyrimet që me lindin nga legjilacioni i Republikës së Shqipërisë
dhe nga rregulloret e miratuara nga Këshilli i Bashkisë Tirane, në lidhje me detyrën time si
mbledhës i nënshkrimeve për peticionin me numër identifikimi 1051040262 për të shpallur për
nënshkrime me datë 15/10/2022

Deklaroj se gjatë detyrës sime si mbledhës i nënshkrimeve për peticionin, unë angazhohem për sa vijon:

1. Të gjitha nënshkrimet e peticionit që do bëhen në vendin e mbledhje së nënshkrimeve ku unë do të angazhohem, do të bëhen në praninë time;
2. Do të zbatoj kërkesat e rregullores së Këshillit Bashkiak Tirane për nënshkrimin e peticioneve;
3. Nuk do influencoj asnjë person të nënshkruaj peticionin kundër dëshirës së tij/saj;
4. Çdo personi në vendin e nënshkrimit do t'i jap mundësinë të lexojë të plotë kërkesën e peticionit dhe sqarimet që shoqërojnë fletët e peticionit.
5. Çdo kërkesë për sqarim në lidhje me peticionin, të bërë nga persona e pranishëm në vendin e nënshkrimit, do të përgjegjem me korrektesë, saktësi dhe përgjegjshmëri

Dorë Heqja Gjyshore për Zhvillim / Projekti POP

Emeralda Hoxha
(Nënshkrimi)

15.09.2022
(Data)

Kontakt:

Adresa: Bomba Alanca Gjyshore për Zhvillim Prapa "Abdy/Prashin" A kull Tirane

Cel: 0696120169

Email: perballja.ofertavepolitike@gmail.com

Dorëzuar pranë Bashkisë Tirane më datë 13/10/2022

PETICION

**PER AFISHIMIN E ORAREVE DHE STACIONEVE NË VENDQËNDRIMET E
AUTOBUSEVE TË LINJAVE TË TRANSPORTIT PUBLIK NËN MENAXHIMIN E
BASHKISË TIRANË SI EDHE RITJEN E FREKUENCËS SË LËVIZJES DREJT DHE
NGA NJËSITË ADMINISTRATIVE LARG QYTETIT**

BASHKIA TIRANË

Nr. 22 prot

Tiranë, më 12.10.2022

Drejtuar:

Znj. Romina Kuko, Kryetare e Këshillit Bashkiak, Tiranë

Këshillit Bashkiak Tiranë

Për dijeni:

Z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë,

Kërkesa:

Ne qytetarët e bashkisë Tiranë, jo pak herë kemi identifikuar problemet me transportin publik të hasura ndër vite, ku ndër to kemi identifikuar edhe dy probleme kryesore të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në përditshmërinë dhe lëvizjen tonë:

1. Mungesa e afishimit të orareve dhe stacioneve në vendqëndrimin e urbanëve
2. Frekuenca e ulët e levizjes së autobuzëve në linjat që janë më larg qendrës së qytetit siç janë linjat për/dhe në Dajt, Baldushk; Farkë etj

Këto problematika na i kemi ngritur në fokus grupet e organizuara nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (Anetare e Rrjetit Përballja e Ofertave Politike – POP) në kuadër të përpilimit të Kontratës Sociale POP me prioritetet e qytetarëve dhe gjithashtu prezantuar në forumin publik të datës 25.6.2019 kur Kontrata Sociale POP dhe kërkesat tona si qytetarë u pranuan nga kryetari i bashkisë Z. Erion Veliaj dhe u mor angazhimi për përbushjen e tyre gjatë mandatit katër vjeçar.

Organizata Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" (duke patur si qëllim të mbështesë grupimet komunitare që të aktivizohen dhe advokojnë për të adresuar nevoja të

komunitetit), na ka mbështetur duke lehtësuar procesin e shkrimit të peticionit dhe ndjekjes së rrugës zyrtare për adresimin e problemit tonë.

Mungesat e sipërpërmendura ndikojnë shumë në lëvizjen e fëmijëve tanë për në shkollë apo lëvizjen tonë për të shkuar në punë apo aktivitete të tjera, duke sjellë jo vetëm vonesa por edhe kaos në stacionet e autobusëve. Gjithashtu, linjat të cilat mbulojnë njësitë administrative pak më larg qytetit, kanë lëvizje të rralla me rreth 40-60 min pritje, duke shkaktuar kështu përsëri kaos dhe vonesa për ne.

Nëse do të afishohen oraret e lëvizjes së autobusave si edhe nëse do të shtohet frekuenca e lëvizjes së tyre sidomos në njësitë administrative që janë më larg qytetit do të na ndihmonte shumë në përditshmërinë tonë.

Kërkesën tonë e bazojmë tek: Ligji 139/2015 për vetqeverisjen vendore neni 8, neni 15, pika 1, neni 16 pika 1, neni 54 germa k, neni 19 pika 2. Si edhe në nenin 18 Seancat e këshillimeve me bashkësinë pika 1 dhe pika 2.

Ne të nënshkruarit e mëposhtëm kërkojme me këtë peticion që të bëhet:

- 1- Afishimi i orareve të lëvizjes së urbanëve në stacionet e vëndqëndrimit të autobusëve si edhe të stacioneve përkatëse.
- 2- Shtimin e frekuencës së lëvizjes së autobusëve drejt/nga Njësitë Administrative Dajt, Farkë dhe Baldushk.

Deklarojmë me përgjegjesi se të gjitha emrat dhe firmat janë të sakta.

Ky peticion fillon me faqen nr. 1 dhe mbaron me faqen nr. 5

Parashtruesit e peticionit gjenden në dokumentin bashkëlidhur

Aneks 7 – Aplikimi i dorëzimit të Peticionit të qytetarëve në bashkinë Tiranë datë 13.10.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
FORMULAR APLIKIMI

Nr Aplikimi AL012008-356722-TIR

Datë 13/10/2022

Nr. prot. P. 23704

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

1.NIPT			
2.Emri i Subjektit	Për Aleancën Gjimore për Zhvillim, Rrjeti Pop		
3.Forma ligjore	OJF	4.Statusi	Aktiv
5. NID	I05104026L	6.Administrator/ Perfaqesues I Subjektit	Esmeralda Hoxha
7. E-mail	perballjaofertave@gmail.com		
8.Cel/Tel	0696120169		
9. Adresa	Tirane Tirane "Abdyl Frashëri"		

SEKSIONI B: INFORMACION MBI APLIKIMIN

Bazuar në: Kodin e Procedurave Administrative dhe Ligjin nr.119/2014 datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit".

1. Kodi i shërbimit: AL012008
2. Tarifa: 0.00
3. Shërbimi: Kërkesë e përgjithshme
4. Data e përgjigjes: 11/12/2022
5. Arsyet e Aplikimit: Në cilësinë e përfaqësues së shoqatës, kërkoj të dorëzoj peticionin bashkëlidhur, për afishimin e orareve dhe stacioneve në vendqëndrimet e autobusave të linjave të transportit publik nën menaxhimin e Bashkisë Tiranë, si dhe rritjen e frekuencës së lëvizjes drejt dhe nga Njësitë Administrative larg qytetit, e firmosur nga 100 qytetarë. Bashkëlidhur dokumentat përkatëse. Mbetem në pritje të shqyrtimit të kësaj kërkesë.



BASHKIA
TIRANË

	Emërtimi i dokumentit të dorëzuar	Nr. i faqeve	Lloji i dokumentit
1.	Kërkesë dhe Peticion	24	Origjinale Fotokopje
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			
9.			
10.			
11.			
12.			
13.			
14.			
15.			
	Gjithsej	24 fletë	

A.BEQIRI



E.HOXHA



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Kontakt

Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim"

Adresa: Rr."Abdyl Frasherit", P.10/1, Tirana, Albania P.O Box 2418

Tel: +355 4 22 555 14

Cel: +355 68 20 59 301

Web: <https://gadc.org.al/>

E-mail: gadc@gadc.org.al

<https://www.facebook.com/GADCAIbania>

https://www.instagram.com/gadc_albania/

https://twitter.com/GADC_AI

<https://www.youtube.com/channel/UCUZJnKqwQ0cURSqKPc1NaXQ>